





AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Financë” me profile: “Kontabilitet” dhe “Bankë”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë
Universiteti “Metropolitan i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr. Ingrid Shuli 
2. Prof.Asoc.Dr. Brikena Leka 

Dhjetor 2020

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bsc në “Financë” me Profile: “Kontabilitet” e “Bankë”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Metropolitan Tirana”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë-Bankë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në <u>“Financë” me Profile- “Kontabilitet” e “Bankë”</u>
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr.16, datë 19.01.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE / 10 PAK
18	Numri i studentëve:	36
19	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT BACHELOR NË “FINANCË” ME DY PROFILE: “KONTABILITET” E “BANKË” NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Metropolitan Tirana” (UMT) ka filluar aktivitetin e tij me VKM Nr. 357, datë 12.05.2010 “Për licensimin si IAL”. Me urdhër Nr. 519, datë 18.10.2010 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ky institucion është pajisur me leje për fillimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore dhe akademike qysh në vitin 2011-2012 dhe organizohet në dy fakultete: Fakulteti i Inxhinjerise & i Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti i Ekonomisë. Nga momenti i fillimit të aktivitetit, UMT ka kryer 3 akreditime institucionale dhe 13 akreditime të programeve mesimore të studimit. Me Urdhërin Nr. 611, datë 31.10.2018, është miratuar Statuti i Universitetit Metropolitan nga Senati Akademik.

Pas riorganizimit të UMT-së si universitet, është miratuar riakreditimi institucional në nivel universiteti. Universiteti Metropolitan Tirana ka nisur aplikimin për akreditimin e Programit të Studimit Bachelor në “Financë” me dy profile: “Kontabilitet” e “Bankë”, me shkresën nr 188, datë 24.10.2019.

Programi i studimit Bachelor në “Financë” me dy profile: “Kontabilitet” e “Bankë”, është program i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, e në fund të këtij cikli studentët e këtij program studimi fitojnë 180 kredite (ETCS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Ky program ka dy profile studimi: Kontabilitet dhe Bankë. Studentët e regjistruar në vitin e parë, pavarësisht profilin të ndjekur, dy vitet e para akademike ndjekin të njëjtat lëndë. Profilizimi ndodh në vitin e tretë të studimit.

Programi i studimit parashikohet të realizohet në 2640 orë gjithsej, nga të cilat 1860 orë janë orë studimi në auditor dhe 780 orë janë orë studimi individual. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore. Në fund të vitit të tretë në planin mësimor të këtij program studimi, parashikohet të kryhet praktika mësimore me rreth 80 orë e 6 kredite (ETCS).

Qëllimi i këtij program studimi është të përgatisë specialistë finance, të profilizuar në specialistë kontabël dhe specialistë financierë, të pajisur me njohuri bashkëkohore teorike dhe shprehuri të duhura praktike, për t’u përgjigjur kërkesave të tregut, të biznesit për këto profile. Aktualisht në këtë program studimi janë të regjistruar dhe vazhdojnë studimet 36 studentë.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtë

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Financë" me profile "Kontabilitet" dhe "Bankë", të ofruar nga Departamenti Financë-Bankë, i Fakultetit të Ekonomisë pranë Institucionit të Arsimit të Lartë- Universiteti Metropolitan i Tirana (UMT) filloi me trajnimin pranë ASCAL, marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë.

ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UMT-ja, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Ingrid Shuli dhe Prof. Asoc. Brikena Leka. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Muhamed Prezja.

Në bashkëpunim dhe me kordinatorin teknik të ASCAL u caktuan datat e vizitës në institucion si dhe u përgatit axhenda e takimeve që do të realizoheshin. Axhenda iu dërgua paraprakisht edhe institucionit. Përpara vizitës në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi një takim me kordinatorin e ASCAL, ku u diskutuan elementë të vlerësimit të programit.

Vizita dy ditore në institucion u zhvillua në datat 21 dhe 22 Shtator 2020. Gjatë kësaj vizite, GVJ u takua me: Zv. Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Përgjegjësin e Departamentit Financë-Bankë; grupin e vlerësimit të brendshëm; pedagogët e aktivizuar në këtë program studimi; studentë të këtij programi studimi, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të zyrës së Kurrikulës, përfaqësues së zyrës së Projekteve, përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të zyrës së Shërbimit të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u vizituan ambjentet e institucionit ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, si edhe ambjentet e bibliotekës.

Pas vizitës në Institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm diskutoi për çështje dhe problematika që dolën gjatë shqyrtimit dhe analizës të materialeve të paraqitura nga institucioni, diskutimeve gjatë ditëve të takimit, si dhe shqyrtimit dhe analizës së materialeve shtesë që iu kërkuan institucionit në ditën e dytë të vizitës. Më tej ky grup filloi punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm.

Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft raportin tek kordinatori teknik i ASCAL.

Më datë 05.11.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 18/19 datë 05.11.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 25.11.2020, përmes sistemit AMS, dërgohet shkresa zyrtare e Institucionit, me Nr. 18/27 Prot., datë 25.11.2020, me lëndë "Mbi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit të studimit Bachelor në Financë me profile: "Kontabilitet" dhe "Bankë"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportit, shprehet si vijon:

Lidhur me komentin për Standardin III.3, kriteri 2, nuk merret ne konsideratë nga ana e GVJ-së.

GVJ është shprehur se mjedisi i bibliotekës nuk ofron hapësirën e duhur për tituj të rinj, por edhe për të akomoduar studentët brenda bibliotekës. Biblioteka i shërben të gjithë studentëve të UMT-së (niveli Bachelor dhe Master) dhe jo vetëm të studentëve të këtij program studimi.

GVJ ka konsideruar Evidencën 107 FE Ambjentet për infrastrukturën të UMT dhe vizitën në institucion, veçanërisht vizitën në bibliotekën e UMT.

Lidhur me komentin për Standardin III.3, kriteri 5, nuk merret ne konsideratë nga ana e GVJ-së.

GVJ, ka shprehur mendimin se ende ka nevojë për libra si fond fizik në bibliotekë, veçanërisht për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi. Jemi dakort me faktin që studentët në UMT mund të përdorin edhe bibliotekën elektronike, botimet në internet sipas sugjerimeve të pedagogëve për mësimin apo për detyrat e kursit, megjithatë literatura fizike për tu konsultuar nga studentët duhet të jetë e pasur dhe sa më koherente.

Lidhur me komentin për Standardin III.3, kriteri 10, nuk merret ne konsideratë nga ana e GVJ-së.

GVJ ka shprehur mendimin se pavarësisht faktit se të gjithë rregulloret dhe dokumentat institucionale e parashikojnë të drejtën e plotësimit të detyrimit përfundimtar nga ana e studentëve qoftë me provim apo me diplomë, institucioni vendosi se të gjithë studentët do të zhvillonin një provim përfundimtar. Nga takimi me studentët rezultoi se një pjesë e tyre dëshironin të mbronin temë diplome. Pra, Fakulteti i Ekonomisë duhet të bënte më shumë për të informuar studentët mbi të dy mundësitë që lejonte rregullorja e UMT e Rregullorja e Provimeve për plotësimin e detyrimit përfundimtar të studentëve.

GVJ ka shqyrtuar Evidencën 63 Procedura për zhvillimin e provimeve, Rregulloren e UMT dhe Aneks 64 Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës, të evidentuara edhe nga GVJ në referencat mbështetese për standartin III-3, kriteri 10.

Lidhur me komentin për Standardin III.7, kriteri nuk merret ne konsideratë nga ana e GVJ-së.

GVJ e ka evidentuar qysh në kriterin 2 të Standartit II.1 opinionin për ndarjen e Programit të Studimit Bachelor në "Financë" në dy profile "Kontabilitet e Bankë dhe më pas në kriterin 2 të standartit III.7. Aty kemi argumentuar se duhet të justifikohet, arsyeja e ndarjes në dy profile, ose në planin mësimor duhet të ishte më i kuptueshëm dallimi mes lëndëve të një profili dhe të profilit tjetër. Theksojmë se jemi bazuar në Aneksin Nr 54 Planin mësimor i Programit të Studimit Bachelor në Financë kur kemi parashtruar opinionin tonë.

Pasi shqyrtuam dokumentin shtesë nr. 1 për Planin Mësimor të Programit të Studimit Bachelor në Financë, vërejmë se është paraqitur ndryshimi që përmendni ju në komentet tuaja, pra janë ndryshuar lëndët e fushës së kontabilitetit si: Auditim, Sisteme Kompjuterizuara, e janë

zëvendësuar me lëndë të fushës së Financës e Bankave: Kontabilitet Bankar, Teknikë Bankare e Manaxhim i Riskut.

Plani mësimor miratohet në department dhe në dekanat para se të fillojë viti akademik, pra nuk mund të ndryshojë më pas e të paraqitet si informacion shtesë.

GVJ ka shqyrtuar Aneks 54 Plani mësimor i programit, Aneks 53 Të dhëna të përgjithëshme mbi programin; Raporti Vlerësimit të Brendshëm për Programin Bsc në Financë dhe Kontabilitet në referencat mbështetese për standartin III-7, kriteri 2.

Lidhur me komentin për Standardin III.8, kriteri 1 nuk merret ne konsideratë nga ana e GVJ-së.

GVJ e ka evidentuar qysh në Standartin III.3, Kriteri 10 që studentët e vitit të tretë të këtij programi studimi duhet të ishin informuar në mënyrë më të qartë nga ana e fakultetit për mundësinë e plotësimit të detyrimit përfundimtar me provim formimi apo me diplomë, megjithëse në Rregulloren për Programin e Studimit dhe Rregulloren e Provimeve, shprehet se njesia bazë para se të nisë semestri i dytë i vitit të fundit, njofton studentët me email për t'informuar për formën e diplomimit dhe afatet përkatëse, nga takimi me studentët nuk rezultoi se është bërë ky informim.

GVJ ka shqyrtuar si evidencë mbështetëse për këtë kriter Evidencën 120 Rregullore e provimeve, Evidencën 58 Rregullore e programit të studimit.

Lidhur me komentin për Standardin VI.3, Kriteri 2 nuk merret ne konsideratë nga ana e GVJ-së.

GVJ e ka evidentuar që në standartin V-3 që studentët e vitit të tretë të këtij program studimi janë brezi i parë i të diplomuarve, gjë që nënkupton që ALUMNI për këtë grup nuk mund të realizohet. Megjithatë ka evidentuar që ndërkohë Fakulteti i Ekonomisë ka diplomuar studentë prej vitesh në fushën e ekonomisë. Pra theksi është vënë që rrjeti ALUMNI që i referohet studentëve të diplomuar më parë pranë këtij fakulteti, duhet të kishte një rol më të madh në informimin e studentëve drejt nevojave të tregut të punës, dijeve që nevojiten, praktikave mësimore si dhe mundësive për punësim, duke konstatuar që roli i rrjetit ALUMNI në këtë institucion duhet të jetë më i madh.

Edhe gjatë takimeve në institucion, si në takimin me NJSBC-në, por veçanërisht në takimin me zyrën e ALUMNI dhe këshillimit të karrierës doli në pah rëndësia e forcimit të rrjetit ALUMNI dhe rolit të tij në institucion.

GVJ ka konsideruar evidencën Nr. 47 (seksioni IV) dhe evidencën Nr.73 (seksioni IV), ku konstatohet krijimi i rrjetit ALUMNI, të evidentuara edhe nga GVJ në referencat mbështetese për standartin VI-3 kriteri 2.

Lidhur me komentin për Standardin VI.3, Kriteri 4 nuk merret ne konsideratë nga ana e GVJ-së.

Kriteri 4, i standartit VI.3 kërkon përdorimin sistematik të instrumentave të tjerë të tërthortë, për vlerësimin e cilësisë së programeve. RVJ ka vlerësuar përdorimin e pyetsorëve për studentët si shumë efikas *(kemi sugjeruar vetëm që një pjesë e tyre të plotësohen on-line për të rritur*

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 6

transparencën dhe cilësinë), por ky ishte instrumenti i vetëm që përdorej nga NJSBC-ja, krahas “vizitave në auditor për të vlerësuar pedagogët” që realizohej nga departamenti përkatës. Ndërkohë nuk aplikohen pyetsorë apo intervista me stafin akademik (PAE dhe PAK) apo joakademik, apo me rrjetin ALUMNI. Pavarësisht se ky program nuk ka arritur akoma të ketë rrjet ALUMNI ritheksojmë që mund të ishte marrë opinioni i ALUMNI-t ekzistues që është diplomuar në fushën e ekonomisë. Për më tepër pyetsorët dhe intervistat organizohen në rang Institucioni dhe NJSBC-ja nuk përdor këto instrumenta as për programet ku aktualisht ka rrjet ekzistues ALUMNI.

Edhe në RVB-në e hartuar nga institucioni është shprehur që planifikohen të organizohen pyetsorë edhe me aktorë të tjerë brenda institucionit.

GVJ ka konsultuar materialin në evidencën Nr. 10 dhe evidencën Nr.11 gjatë analizës për përmbushjen e kriterit 4, në standartit VI-3.

Lidhur me komentin për Standardin VI.4, Kriteri 5, nuk merret në konsideratë nga ana e GVJ-së.

Mendojmë që nuk është kuptuar mirë komenti ynë. Ky kriter kërkon që pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen **edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm** që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.

Komenti i Institucionit që merret në konsideratë edhe opinioni i PAE, të cilët mbulojnë 75% të programit, është evidentuar edhe nga GVJ që ka konstatuar faktin që 75% e programit mbulohet nga PAE, si dhe që merret në konsideratë opinioni i tyre i cili është i një rëndësie të veçantë dhe primare. Por ky kriter kërkon që të evidentojmë rolin e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm. Prandaj në kemi evidentuar rolin e PAK në vlerësim, por ndërkohë edhe nevojën për integrim të formalizuar të ekspertizës nga bashkëpunëtorët dhe ekspertë të jashtëm me qëllim rritjen e cilësisë së programit. Ndërkohë për arsyet e përmendura në komentet e mësipërme, duhej të ishte tërhequr opinioni i rrjetit ALUMNI ekzistues të fushës së ekonomisë.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë” me profile: “Kontabilitet” dhe “Bankë”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion, dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, rezulton se UMT është akredituar institucionalisht me VKM Nr.357, date 12.05.2010, me Urdhër Nr.519, datë 18.10.2011 të Ministrit Arsimit e Shkencës. Më pas me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 117, datë 15.12.2017 UMT-ja është akredituar intitucionalisht përsëri dhe bashkë me të edhe programet e studimit. Akreditimi i fundit është ai institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 45, datë 05.07.2019.</p> <p>Misioni i UMT-së për programin e studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” e “Bankë” është ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës për studentët që përzgjedhin këtë program, ofrimi i kualifikimit dhe i ndjekjes së veprimtarive të tjera të lidhura me punësimin.</p> <p>Vizioni i UMT-së është promovimi i vlerave kombëtare përmes ofrimit të edukimit/arsimit me qëllim nxitjen e respektimit të etikës qytetare, të profesionalizmit, nxitjen e respektimit të kodeve të sjelljes, me synim formimin e një qytetarie model për konsolidimin e vlerave dhe interesave kombëtare në fushën e arsimit.</p> <p>UMT ofron programe studimi në përputhje me politikat kombëtare, duke përgatitur specialistë të aftë për sipërmarrje, inovacion, duke mundësuar dhe punësimin në përgjigje të interesave kombëtare</p> <p><i>[Evidenca 13 UMT Vendimi për akreditimin institucional të UMT nga Bordi i Akreditimit dhe certifikata e akreditimit.pdf; Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; Evidenca 4 UMT Organigrama.pdf; Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilit-1.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Mbështetja dhe promovimi i vlerave kombëtare është detyrim i UMT-së. Personeli akademik i Fakultetit të Ekonomisë ka punuar për zhvillimin e programeve të shkencave ekonomike në UMT. Lidhur me këtë një ndihmesë e madhe ka qenë bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, me të cilat UMT-ja ka marrëveshje.</p> <p>Programet e studimit, në veçanti ky program i studimit Bachelor në Financë në profilet Kontabilitet e Bankë synon transmetimin e njohurive në shërbim të vendit dhe shoqërisë. Synojnë kualifikimin profesional të studentëve në fushën e ekonomisë, e veçanërisht në profilet specifike</p>

	Kontabilitet e Bankë. Kërkimi shkencor është pjesë integrale e këtij program studimi, duke i nxitur studentët jo vetëm të kualifikohen në fushën përkatëse, por edhe të bashkëpunojnë me pedagogët në kërkimin shkencor, si dhe të punojnë për kërkim të pavarur në këto fusha. [Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf; Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilit-1.pdf]			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nisur nga RVB-ja dhe dokumentacioni që është përcjellë nga IAL, DVV, Programi i studimit Bachelor në Financë në profilet Kontabilitet e Bankë është në përputhje me synimet dhe misionin e institucionit sipas statutit dhe strategjisë së UM-së. Misioni i institucionit konsiston në edukimin e studentëve në fushat e shkencave inxhinierike dhe të ekonomisë duke u mbështetur në programe bashkëkohore studimi, në kërkimin shkencor, në vënien në praktikë të dijeve të marra nga studentët në bizneset private, pranë institucioneve publike, organizatave jo fitimprurëse, etj. [Evidenca 3 UMT Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf; Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 7.]			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ konstatoi që ky program studimi që kërkohet të akreditohet është hartuar nga UMT-ja në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik të vendit, duke ofruar module të kombinuara me karakter të mirëfilltë teorik e praktik, nga fusha ekonomiko-shoqërore, njohuri për sipërmarrjen, duke përfshirë praktikatat profesionale etj. Në planet mësimore, programet e lëndëve (syllabus), pasqyrohen kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, i ndryshuar me VKM Nr. 897 date 18.12.2019, si dhe Udhëzimi Nr. 1, date 14.01.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njesive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve”. Ofrimi i këtij program studimi ka ardhur si kërkesë e tregut për specialistë të financës, kontabilitetit dhe të bankës. Studimet në këtë program synojnë të pajisin studentët me njohuri teorike e praktike, si dhe përgatitje për kërkim shkencor të pavarur në këto fusha. [Aneks nr 56.1 e 56. 2 Plan programet e lendeve programi Finance-Syllabus.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar dokumentit “Strategjia e Zhvillimit të UMT-së” miratuar nga Senati me vendim 224/1, datë 08.04.2019, RVB-së dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton që hartimi dhe përditësimi i Programit të Studimit mbështetet gjatë realizimit të tij në strategjinë për zhvillimin e institucionit. Një ndër objektivet strategjike të UMT është hartimi i

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 9

	<p>programeve akademike te avancuara e bashkëkohore, zhvillimi i programeve te reja ndërdisiplinore, që ndikon në rritjen e bashkëpunimit brenda institucionit apo edhe me institucione të tjera.</p> <p>[Evidenca 3 UMT Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf, fq 4; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 8.]</p>								
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit Bachelor në Financë, ky program studimi ofron përgatitje dhe diplomim të studentëve me spektër të gjerë njohurish në fushën e financës, kontabilitetit, pa lënë pa përmendur lëndë si matematika, informatika, manaxhimi i biznesit, sipërmarrja. Në këtë mënyrë studentët marrin njohuri të domosdoshme për zhvillimin e karrierës dhe u krijojnë mundësi për të mësuar e për t'iu kualifikuar për zhvillimin në profesion gjatë gjithë jetës. [Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf]</p>								
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit i referohet dhe është i lidhur drejtpërdrejt me fushat që ka vendosur ndër prioritetet e tij UMT, bazuar në Statut (Evidenca 1) dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht në VKM nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, i ndryshuar me VKM nr. 897, datë 18.12.2019, si dhe Udhëzimi Nr 1, datë 14.01.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njesive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve”.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga elementet mësimore si lëndet, modulet, praktika mësimore, diploma, të cilat formojnë studentet si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga ajo praktike në fushën e financës e kontabilitetit. [Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilitet-1.pdf]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Objektivat kryesore të këtij programi studimi në “Financë” me profilet: Kontabilitet e Bankë, janë rezultat i pritshëm i arritjeve të studentëve në procesin mësimor e edukativ.</p> <p>Ky program studimi Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”, synon të përgatisë specialistë të mirë si kontabilistë, financierë, punonjës të bankave në fushat e studimit që mbulon, për t’i aftësuar për tregun e punës, në fushën e administrim biznesit, në institucionet financiare etj. , nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Transmetimit të njohurive ekonomike e aftësive praktike; - Zhvillimit të aftësive individuale të studentëve për të bërë

	<p>analiza në fushat e kërkimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aftësim për të analizuar e zgjidhur probleme individualisht apo në grup të studentëve. <p><i>[Aneks nr 53 Te dhëna te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilitet-1.pdf; Aneks nr 58 Rregullore e programit.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Sipas dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, RVB, programi i studimit bachelor në “Financë” me profile në “Kontabilitet” e “Bankë”, zhvillohet bazuar në prijet, prioritetet e zhvillimit të ekonomisë në nivel kombëtar, duke iu referuar publikimeve të organizmave dhe Institucioneve kryesore ekonomiko-financiare në vend si psh: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, publikime të institucioneve ndërkombetare, si Banka Botërore, FMN etj.</p> <p>Për hapjen e këtij programi sipas takimeve në institucion e RVB-së është kryer studim i tregut, për të argumentuar rëndësinë e hapjes së këtij program studimi, sipas analizës që i është bërë sektorit, faktorëve kulturorë dhe socialë, etj. Analiza e tregut është bazuar në të dhëna të matëshme apo të dhëna reale të brendshme dhe të jashtme, po kështu edhe në të dhëna jo të matëshme, si: konceptet hulumtuese, sociale e kulturore. Kjo analizë tregu është bazuar edhe në rezultate statistikore si, sondazhe, pyetësorë, në praktikat më të mira ndër eksperiencat ndërkombëtare, pra është realizuar një analizë tregu e mirëfilltë. <i>[Aneks nr 74 Studim mbi Tregun e Punës.pdf, fq 3: Raporti i Vlerësimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 9]</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësit, garantojnë përfitimim e dijeve, aftësive, shkathtësi e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Fushat e studimit të përfshira në këtë program studimi, krijojnë mundësinë që pas marrjes së diplomës Bachelor në Financë ne profilet Kontabilitet dhe Bankë, studentët të kenë mundësi punësimi në zyra kontabiliteti, banka, institucione financiare, etj. Për identifikimin e vlerësimit e nevojave të tregut të punës UMT ngarkon për të bërë studimin e tregut qendrat e tij kërkimore, zyrën e marketingut me qëllim që të orientohen studentët. Nga takimi me drejtues të UMT rezulton se studentët e këtij program studimi janë thuajse të gjithë të punësuar. Në programin e studimit Bachelor në Financë e profile Kontabilitet e Bankë, praktikat profesionale janë pjesë e planit mësimor. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UMT, mbajnë komunikim të vazhdueshëm me kompani dhe banka, për të mundësuar zhvillimin e praktikave mësimore, por edhe për punësimin e studentëve. UMT lehtëson punësimin e studentëve, por edhe i ndjek ata në karrierën e tyre përmes zyrës Alumni.</p> <p>Pra, struktura e programit të studimit, objektivat formues dhe përmbajtja e programeve të studimit të këtij programi studimi, u garantojnë studentëve marrjen e njohurive, dijeve, aftësive e kompetencave për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të lehtësuar e mundësuar punësimin e studentëve. Një shembull i mirë janë leksionet e hapura me specialist të fushave te ndryshme për të sjellë ekspertizën e tyre në auditor, si edhe mbikqyrja e studentit në praktikën mësimore si pjesë e programit mësimor, nga specialistë të</p>

	bizneseve ku kryhet praktika mësimore. Universiteti UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me njësi biznesi, me institucione bankare, financiare për të çuar studentë për praktika mesimore, për të marrë kërkesat specifike të tyre mbi aftësitë dhe kompetencat që duhet të kenë fituar studentët në këtë program studimi. [Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf; Evidenca 23 UMT Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf; Evidenca 28 UMT Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT.pdf; Evidenca 82 UMT Rrjeti Alumni dhe aktivitete.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi L4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Sipas RVB e vizitës në institucion, dhe sipas evidencave të përcjella nga IAL, DVV, rezultoi se Fakulteti i Ekonomisë në UMT, nxit inovacionin në mësimdhënie në një mjedis ku në qendër është studenti, duke shfrytëzuar teknologjitë e reja në mësimdhënie, duke promovuar e rritur rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, si dhe përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit. Të gjitha programet e studimit përfshirë dhe ai i Financës, që ofron Fakulteti i Ekonomisë në UMT, janë në përputhje me fushën e studimit që mbulon Fakulteti i Ekonomisë dhe njësia bazë që zbaton këtë program studimi. Fakulteti i Ekonomisë disponon kapacitetet akademike dhe të infrastrukturës, për zbatimin e këtij program studimi, në përputhje me standartet e cilësisë. Personeli akademik (efektiv apo me kontratë) i Fakultetit të Ekonomisë të UMT, respekton kriteret ligjore të titujve dhe gradave, për cdo njësi bazë dhe për cdo cikël studimi. Një pjesë e personelit akademik ka kryer studime universitare dhe /ose pasuniversitare jashtë vendit. <i>[Evidenca 66 FE Lista e Plotë e personelit akademik me kohë të plote, me kohë të pjesshme FE.pdf; Evidenca 67 FE Lista e plotë e personelit akademik dhe administrativ.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ, referuar RVB-se si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, vlerëson se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Financë me profile "Kontabilitet" dhe "Bankë" është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë, sipas klasifikimit të programeve të studimit, në përputhje me udhëzimet kombëtare e evropiane. Përmendim se referuar fushave të përgjithshme studentët marrin njohuri e aftësohen për tregun e punës, duke njohur funksionimin e institucioneve financiare, bankare, shoqërive aksionare, duke studiuar kontabilitetin, e duke marrë formim profesional në fushën përkatëse. Ndërsa, referuar fushës specifike, kurrikula e studimeve

	mundëson që studentët të përgatiten si specialistë të aftë të fushës së financës, kontabilitetit, bankave dhe institucioneve financiare. [Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilit-1.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Referuar RVB-se, Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë dhe takimeve me drejtues të njesisë kryesore dhe të njesisë bazë, rezultojnë se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë bazë, pra të Departamentit Financë Bankë, përgjegjës për programin e studimit, duke respektuar klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Departamentit Financë Bankë si njesi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, angazhohet për të mbuluar të gjitha lëndët e planit mësimor. Për programet me karakter ndërdisiplinor, apo kur bëhet fjalë për lëndë specifike, apo për lënde të trungut, të dy viteve të para, në të cilat studentët zhvillojnë të njëjtat lëndë, në bazë të marrëveshjeve, bashkëpunon me IAL të tjera, jashtë UMT, apo angazhon personel akademik të njësive të tjera bazë. [Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilit-1.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në takimet me drejtuesit e njesisë kryesore, bazuar edhe në Organigramën e UMT, GVJ-ja konstatoi se në UMT të gjitha strukturat administrative dhe akademike të institucionit bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e synimeve të këtij programi studimi, lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe aktivitetet e tjera ekstra kurrikulare. Të gjitha detyrat specifike të personelit akademik, të njësive bazë e të njësive kryesore në këtë kuadër janë përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore, në statutin e UMT, në rregulloren e UMT dhe në rregulloren e njesisë kryesore, pra Fakultetit të Ekonomisë. Me qëllim marrjen e informacionit për ecurinë, çdo hallkë e këtij institucioni, UMT, raporton në mënyrë periodike për aktivitetet e kryera. Çdo njesi bazë bën analizë periodike të punës së stafit të vet akademik, përmes matjes së performancës së mësimdhënies dhe rezultateve semestrale dhe vjetore të studentëve, të cilat më pas bëhen pjesë e Raportit të aktivitetit mëimor, kërkimor dhe financiar të Fakultetit të Ekoomisë të UMT. [Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; Evidenca 50 FE Rregullore

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 13

	<i>e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; Evidenca 4 UMT Organigrama.pdf; Evidenca 73 FE Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf]</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	GVJ, referuar RVB-se si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se UMT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të arsimit të lartë brenda vendit, po kështu në nivel akademik bashkëpunon edhe me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, si në rastin e Universitetit të Mesinës, Universiteti i Molisse etj. UMT ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione private e publike të vendit apo ndërkombëtare. Marrëveshje ka edhe mes UMT-se e aktorëve të biznesit vendas e të huaj. Sipas evidencës 22, UMT ka 43 marrëveshje bashkëpunimi, si u përmendën më lart në këtë kriter. <i>[Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]</i>
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Njësia përgjegjëse e këtij program studimi është Departamenti Financë Bankë, në Fakultetin e Ekonomisë. Kjo njësi bazë si edhe njesitë e tjera bazë të këtij fakulteti, analizojnë periudikisht përfitimet e programit të studimit nga marrëveshjet e nënshkruara si në kriterin më sipër. Rezultatet e këtyre analizave bëhen pjesë e Raportit vjetor të aktivitetit mësimor, kërkimor e financiar të FE. Studentët e FE-se dhe personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në akreditim, kanë përfituar si nga programet Erasmus, po ashtu edhe nga marrëveshjet me biznesin për praktika mësimore e deri në punësim. FE ka tre vjet që praktikon Inkubatorin in Campus, për të mbledhur idetë më të mira dhe duke ofruar trainime dhe ekspertizë përmes organizimeve të bootcampeve. <i>[Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf; Evidenca 73 FE Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf]</i>
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Sipas RVB, vizitës në institucion e dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, si edhe në kriteret 2.3, GVJ konstaton se UMT-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me biznese, për kryerjen e praktikave mësimore. Në bazë të marrëveshjes që UMT ka bërë, sipas evidencave 22 e 23, nga institucioni apo biznesi pritës i studentëve, vendoset një mbikqyrës praktike, i cili i monitoron gjatë gjithë periudhës së parashikuar në planin mësimor për praktikën dhe më pas bën edhe vlerësimin e punës së studentit, vlerësim ky që i bashkëngjitet vlerësimit të pedagogut udhëheqës, deri në mbrojtjen para komisionit të praktikës mësimore. Sigurohet vend praktikë në varësi të natyrës specifike të programit të studimit, kështu studentët e këtij program studimi Financë me profile Kontabilitet e Bankë, zhvillojnë praktikën në zyra kontabiliteti, në banka, në shoqëri sigurimesh, apo në institucione të tjera financiare, në shoqëri tregtare etj. UMT-ja rezulton se ka kontakte të vazhdueshme me bizneset me të cilat ka marrëveshje jo vetëm për praktikën e studentëve, por edhe për trajnime profesionale të stafit të këtyre bizneseve apo për shkëmbim eksperiencë në auditorë nga drejtuesit e këtyre bizneseve. Nga evidenca nr 22, rezultojnë 43 marrëveshje të nënshkruara mes UMT dhe disa universiteteve të huaja dhe bizneseve, ku studentët mund të kryejnë praktikën mësimore. Janë edhe 17 marrëveshje me biznese në proces negocimi, Evidenca 23. <i>[Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në</i>

	<i>rrjete totale.pdf; Evidenca 23 UMT Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf; Raporti i Vleresimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]</i>			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nisur nga RVB dhe nga takimet në institucion me drejtuesit e Fakultetit të Ekonomisë, u informuam se përveç praktikave mesimore, partnerët e UMT-së, ofrojnë internship ose trainime profesionale për studentët dhe stafin. <i>[Raporti Vleresimit Brendshëm për Programin Bsc në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 12]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” e “Bankë” është i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, përmendim VKM nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Struktura e këtij programi studimi pasqyrohet në Rregulloren e Programit të studimit, ku lëndët janë të ndara në elemente mësimore që përcaktohen në VKM nr 41, datë 21.04.2018, duke respektuar të gjitha limitet e shprehura në orë e në kredite ETCS. Programi i studimit organizohet sipas planit të zhvillimit institucional dhe strategjisë së zhvillimit ekonomik kombëtar, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ETCS). <i>[Aneks nr 54 Plani Mesimor për programin Bachelor në Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf]</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Nisur nga RVB e vizita në institucion, informacioni i marrë nga takimet me drejtues të UMT, nga Aneks 53 Të dhëna të përgjithëshme mbi programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë me profile “Kontabilitet” e “Bankë”, GVJ konstaton se ky Program studimi synon përgatitjen e formimit të disa lloje specialitetesh e profesionale si: punonjës në zyrë kontabiliteti që merren me mbajtjen e kontabilitetit, me mbajtjen e arkës ose arkëtar, asistent kontabël, manaxher i dokumentacionit, manaxher në fushën e edukimit, manaxher financiar, manaxher për sistemet e informacionit kontabël, manaxher për sistemet bankare, oficer kredie, drejtues kontabiliteti në biznese apo në banka, etj. Struktura e programit të studimit, të ndarë në dy profile, nëpërmjet

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 15

	<p>kombinimit të lëndëve karakterizuese të programit studimit, me lëndët karakterizuese të profilit specifik Kontabilitet; Bankë mendohet se do plotësojë kërkesat e tregut për specialistë të këtyre profileve. Sipas takimit me drejtues të Fakultetit të Ekonomisë, profili Bankë nuk ka qenë shumë i kërkuar, pasi nuk ka qenë i akredituar. Pasi u testua tre vjet dhe studentët kanë filluar të kërkojnë këtë profil, është kërkuar që edhe profili Bankë të akreditohet. GVJ për këtë çështje ka rezervë, lidhur me diferencimin në planin mësimor të ngarkesës mes lëndëve bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore, dhe do paraqesë argumente për këtë në standartin pasardhës. [Aneks nr 58 Rregullore e programit.pdf; Raporti i Vleresimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10; Minutat e takimit me drejtues të FE]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Finance”, profilet “Kontabilitet” e “Bankë” është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me objektivat strategjike të UMT. Referuar strukturës së programit studentët përfitojnë njohuri të përparuara në nivel programi (Financë me dy profile) si: Matematikë, Mikroekonomi, Makroekonomi, Manaxhim i Operacioneve, etj., dhe gjithashtu njohuri të përparuara në nivel profili specifik si: Tregje Financiare, Analiza e Pasqyrave Financiare, Drejtim Financiar, Financa Publike, etj. [Aneks nr 56 Plan programet e lendeve programi Finance.pdf; Evidenca 3 UMT Plani strategjik i zhvillimit UMT.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit në Financë, profilet Kontabilitet e Bankë, sikurse është përmendur në kriterin 3 më lart, përmban lëndë sidomos në vitin e tretë të studimit (si lëndët e përmendura në kriterin 3 më lart), që zhvillohen edhe në programet master, duke synuar të ofrohen njohuri të avancuara në nivel akademik, por edhe aftësi praktike dhe kompetenca të avancuara, të realizuara përmes detyrave apo projekteve specifike në secilën lëndë. Po kështu, sipas informacioneve të marra në UMT, studentët që përfundojnë studimet bachelor, mund të vazhdojnë studimet në master në një fushë të studimeve që ofron UMT. [Aneks nr 56 Plan programet e lendeve programi Finance.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Ashtu si është përmendur në kriterin 1 të këtij Standarti, struktura e Programit të studimit në “Financë”, profilet “Kontabilitet” e “Bankë”, është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi dhe me VKM nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në veçanti. Studenti në përfundim të ciklit të parë të studimeve siguron, pas 3 vite studimi, 180 kredite ETCS. Sipas VKM 41, 15-20% të krediteve të programit mësimor duhet ta përbëjnë lëndët bazë (kategoria A e veprimtarive formuese), të përgatisin studentin nga pikpamja metodologjike dhe me kulturë të përgjithëshme, 50-55% të krediteve të duhet të jenë lëndë karakterizuese ose lëndë që e përgatisin studentin për disiplinën shkencore (kategoria B); 12-15% të krediteve të programit të studimit e zënë lëndë ndërdisiplinore/integruese, ku përfshihen nëndisiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje (kategoria C), 10-15% të krediteve duhet të jenë lëndë plotësuese si gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (kategoria D) dhe 3-5% të krediteve programit e zënë</p>

	<p>detyrimet përmbyllëse (kategoria E). Duke krahasuar kriteret e VKM me përfshirjen në planin mësimor të programit mësimor situata paraqitet:</p> <p>Për profilin Kontabilitet për të tre vitet:</p> <p>Lëndë të kategorisë A zenë 30 kredite ose 16,6%, pra brenda kriterit të VKM 41.</p> <p>Lëndë të kategorisë B 96 zenë kredite ose 53,5%, pra brenda kriterit të VKM nr 41.</p> <p>Lëndë të kategorisë C zenë 27 kredite, ose 15%, brenda kriterit.</p> <p>Lëndë të kategorisë D zenë 21 kredite ose 11.6%, brenda kriterit.</p> <p>Lëndë të kategorisë E zenë 6 kredite ose 3.3%, brenda kriterit.</p> <p><i>[Aneks nr 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Sipas shpjegimeve të dhëna në kriterin 6 më sipër, sipas RVB-së rezultojnë se në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” e “Bankë”, janë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive nga A-E dhe me ngarkesën përkatëse në kredite, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara nga MASR-ja. Më konkretisht për këtë çështje i kemi referuar për përputhshmëri, VKM nr.41, datë 21.04.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.</p> <p><i>[Aneks nr 55 Plani mesimor sipas veprimtarive formuese.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ-ja, referuar RVB-se si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se UMT-ja është një institucion i akredituar me Vendim të Bordit Akreditimit, Nr 45 datë 05.07.2019, pas riorganizimit të UMT-së në universitet. Fakulteti i Ekonomisë në UMT përbëhet nga 3 njësi bazë, stafi i të cilave plotëson kriteret ligjore për funksionimin e këtyre njësive bazë. Departamenti Financë Bankë ka në përbërje 8 personel akademik efektiv (PAE), 18 personel akademik me kohë të pjesëshme ose me kontratë (PAK), ku 20 anëtarë të personelit akademik janë me grada e tituj, duke plotësuar kriteret ligjore, ndërsa stafi ndihmës akademik dhe ai administrativ është i organizuar në nivel institucioni, pra si UMT. Programi i studimit Bachelor “Financë” me profile “Kontabilitet” e “Bankë” ofrohet nga Departamenti i Financë Bankë.</p>

	<p>Nisur nga CV e personelit akademik, rezulton se pjesë e personelit akademik me kontratë janë personalitete të fushës së financave, kryesisht me titull akademik, të cilët sjellin në auditorë ekspertizën, njohuritë dhe informacionin që kanë në fushat e tyre specifike. [Evidenca 13 UMT Vendimi për akreditimin institucional të UMT nga Bordi i Akreditimit dhe certifikata e akreditimit.pdf; Evidenca 66 FE Lista e Plotë e personelit akademik me kohë të plote, me kohë të pjeseshme FE.pdf; Raporti i Vleresimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>GVJ-ja, konstaton sipas Evidencës 81 të UMT, se për ecurinë e programit të studimit, për ndjekjen e praktikave mësimore të studentëve janë përcaktuar nga cdo njësi bazë koordinorët e programeve të studimit për cdo njësi bazë. Kështu, sipas dokumentit të mësipërm, nga Departamenti Financë Bankë, janë përcaktuar 3 koordinorë, personel akademik efektiv i kësaj njësie bazë. Koordinatorët e programit të studimit dhe të praktikave profesionale informojnë njësinë bazë për ecurinë, dhe nëse ka problematika ato bëhen objekt i analizave e diskutimeve në njësinë bazë. Sipas Aneksit nr. 91 koordinorët e caktuar nga njësia bazë për ndjekjen e praktikave mësimore janë edhe udhëheqësit e praktikës mësimore, në 11 subjekte, si zyra kontabiliteti, institucione qendrore, ndërmarrje etj. [Evidenca 81 UMT Vendim për përcaktimin e koordinorëve të programeve studimore në FE.pdf; Aneks 91 Lista e subjekteve për zhvillimin e praktikës.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Për të realizuar këtë program studimi të ciklit të parë Bachelor në Financë me dy profile, sipas Aneks 53, Organigramës të FE, në UMT janë ngritur strukturat përkatëse në zbatim të legjislacionit në fuqi e për të plotësuar objektivat e misionin e këtij program studimi. UMT si njesi kryesore është e përbërë nga tre njesi bazë: Departamenti Administrim Biznesi, Departamenti Informatike Ekonomike, dhe Departamenti Financë Bankë. Secila prej njësive bazë ka në përbërje të saj jo më pak se 7 pedagogë efektive, nga të cilët minimalisht 3 prej tyre mbajnë gradë e tituj. [Evidenca 51 FE Struktura, organigrama FE.pdf; Aneks nr 53 Te dhena të përgjithshme mbi programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në Finance me profile Kontabilitet-1.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Sipas RVB-së, Evidencës 66 për personelin akademik, rezulton se Fakulteti Ekonomisë në UMT, ka në përbërje 24 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 1 personel akademik me titull Prof.Dr., 4 personel akademik me titull Prof.As., personel akademik në proces doktrature, 4 personel akademik Master i Shkencave (Msc), si dhe 45 personel akademik me kontratë, nga të cilët 7 janë Prof.Dr., 9 janë Prof.As., dhe 21 janë me gradën shkencore Doktor dhe 8 prej tyre janë personel akademik me gradën Master Shkencor (Msc).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Ndërsa, njësia bazë, Departamenti Financë Bankë në Fakultetin e Ekonomisë të UMT, ka në përbërje 8 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 2 personel akademik mbajnë titullin Prof.As., 5 prej stafit akademik mbajnë gradën shkencore Doktor, 1 prej personelit akademik është në proces doktrature. Gjithashtu, kjo njesi bazë ka në përbërje edhe 18 personel akademik me kontrate (PAK), nga të cilët 1 personel akademik me titull Profesor Dr., 4 prej personelit akademik mbajnë titullin Prof. As., 10 prej personelit akademik mbajnë gradën Doktor, 1 staf akademik është në proces doktrature dhe 4 personel akademik janë</p>

	me diplomën Master Shkencor (Msc). [Evidenca 66 FE Lista e Plotë e personelit akademik me kohë të plot, me kohë të pjesshme FE.pdf Tab.nr 2: Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Sipas Struktures organizative te Fakultetit të Ekonomisë, të UMT, e si është shpjeguar në RVB, Departamenti i Financë Bankë si njesi bazë përgjegjëse për programin e studimit, është njesia që propozon dhe ndjek mbarëvajtjen e programit të studimit dhe ndryshimet përkatëse. Çdo propozim për programet e studimit niset nga njesia bazë dhe kalon të gjitha hallkat drejt miratimit të tij nga Senati akademik. Në këtë këndvështrim, të gjitha këto hallka, Departamenti Financë Bankë, Fakulteti Ekonomisë, e kanë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit që zhvillohen në UMT. [Evidenca 51 FE Struktura, organigrama FE.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” e “Bankë”, sipas Rregullores së programit, organizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë të vecantë sipas VKM nr 41, datë 21.04.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Sipas VKM së mësipërme elementët që përbëjnë strukturën e programeve të studimit janë: kreditet (ETCS), kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivet formues e kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese e komponentët mësimorë të programit të studimit, kategoritë e veprimtarive formuese, plani mësimor, programet e lëndëve, etj. Para fillimit të vitit akademik njesia bazë përgjegjëse për programin e studimit përgatit e diskuton Planin mësimor dhe ia propozon Senatit Akademik për miratim. Në planin mësimor ndarja e lëndëve/moduleve, bëhet në disa kategori nga A-E: lëndë të formimit të përgjithshëm (A), lëndë të formimit karakterizues (B), lëndë me zgjedhje (C), lëndë të formimit plotësues, si praktika (D) dhe tema e diplomës (E). Për ndarjen e lëndëve në kategoritë e mësipërme i jemi referuar edhe suplementit të diplomës. [Aneks nr 58 Rregullore e programit.pdf; Aneks nr 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf; Aneks nr 60 Suplementi i diplomes.pdf]
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit	Njesia bazë përgjegjëse për këtë program studimi mban parasysh e zbaton sistemin european për organizimin e programit të studimit në

<p>vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>lëndë e module. Plani mësimor si element përbërës i programit të studimit është i përbërë nga lëndë apo module. Në planin mësimor, çdo lëndë apo modul është i shprehur në kredite (ETCS), në orë mësimore, të ndara në leksione, seminare, praktikë, provime, në orë punë individuale të studentit. Në VKM nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, paraqitet në shtojcën 1, veprimtaritë formuese të ndara në kategori si më poshtë:</p> <p>A-Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithëshme (15-20%= 30 kredite).</p> <p>B-Lëndë karakterizuese: përgatitje për disiplinen shkencore: (50-55% = 96 kredite).</p> <p>C-Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose / dhe integruese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: (12-15% = 27 kredite).</p> <p>D-Lëndë plotësuese: Lëndë formuese dhe aktivitete që lidhen me përfitim të aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikë mesimore: (10-15% = 21 kredite).</p> <p>E-Detyrime përmbyllëse: Teza e diplomes: (3-5% = 6 kredite).</p> <p>[Aneks nr 55 Plani mesimor sipas veprimtarive formuese.pdf; Aneks nr 60 Suplementi i diplomes.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Si është përmendur në kriteret 2, 3 të këtij standarti, në dosjen e programit të studimit ndodhet Rregullorja e programit, e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Plani mësimor si një ndër elementet e programit të studimit përmbledh Lëndet/modulet të shpërndara në semestra, të vlerësuara në kredite ETCS, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore në orë për Leksione, Seminare, Projekte, Detyra Kursi, Praktika, të parashikuara në planin mësimor. Një kredit ETCS i korrespondon 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit. Gjatë një viti studimesh universitare, studenti me kohë të plotë fiton 60 kredite ose 1500 orë mësimore në auditor dhe orë pune te pavarur. Në Rregulloren e programit të studimit si dhe në syllabuset e lëndëve jepen të dhëna të detajuara lidhur me detyrimet e frekuentimit të lëndës nga studentët, si edhe mënyrës së vlerësimit të dijeve.</p> <p>[Aneks nr 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf; Aneks nr 58 Rregullore e programit të studimit.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithëshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithëshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, përshkruhen në Rregulloren e Programit të studimit.</p> <p>Në fillim të vitit, Fakulteti Ekonomisë, në UMT bën propozimin për kuotat e pranimit të studentëve në programin Bachelor në Financë për vitin akademik pasardhës. Parashikimi i numrit të studentëve që do pranohen vitin pasardhës, mbështetet në Studimin e tregut të punës, në analizën e prirjeve të regjistrimeve ndër vite si dhe bazuar në kërkesën e tërheqjes së studentëve nga tregu i punës çdo vit. Programi i paraqitet</p>

	cdo vit palëve të interesuara, në rradhë të parë studentëve, përmes Guidës së studentit, përmes Javës së orientimit të studentëve. [Aneks nr 58 Rregullore e programit të studimit.pdf; Aneks nr 74 Studim mbi tregun e punes.pdf; Evidenca 90 FE Shembull dosje transferimi studimesh.pdf; Evidenca 79 UMT Guida e Studentit pdf; Evidenca 80 FE Java e Orientimit FE.pdf; Takimi ne institucion]			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Sipas kriterëve të mësipërme të këtij standarti, program i studimit Bachelor në Financë, përmban informacionet e nevojshme për programet e lëndëve (syllabuset). Plani mësimor si një ndër elementet e programit të studimit përmbledh Lëndet/modulet, e për secilën lëndë: Leksione, Seminare, Projekte, Detyra Kursi, Praktika, si dhe gjithë komponentët formues të programit brenda e jashtë auditorit. [Aneks nr 56 Plan programet e lendeve programi Finance.pdf]			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga takimet me personelin akademik dhe sipas RVB-së rezulton se Fakulteti Ekonomisë në UMT, në fillim të vitit, risheh përmbajtjen e programeve të studimit për përmirësimet e përditësime në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton ndryshimet duke ndjekur procedurat ligjore dhe i arkivon. Ndryshimet i bëhen të ditura gjithë drejtuesve të njesisë kryesore dhe të njesive bazë, me qëllim zbatimin e plotë të tyre. Procedura e përditësimit ndjek rrugën: departament, dekanat dhe më tej dërgohen për miratim në Senatin Akademik. [Aneks nr 56 Plan programet e lendeve programi Finance.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Sipas RVB-se e dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, si Aneks 57 për ngarkesën totale në auditor, rezulton se ngarkesa e programit të studimit Bachelor në Finance në të dy profilet Kontabilitet e Bankë, rezulton se respektohet ngarkesa ditore javore etj. në auditor, për të zhvilluar leksione, seminare, ushtrime, detyra, etj. Ora mësimore zgjat 50 min, rreth 4-5 ore mësimore në ditë ose 20-25 orë në javë. Ngarkesa për një vit akademik sipas VKM 41, datë 21.01.2018, për një vit akademik është 60 kredite (ETCS), mesatarisht 1500 orë, dhe nga këto jo më pak se gjysma duhet të jenë punë e pavarur e studentit. Ngarkesa e programit të studimit është e strukturuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Njesia bazë përcakton ngarkesën mësimore të cdo pedagogu në lëndën/t që do të mbulojë, përcakton ngarkesën e të gjithë njesisë bazë dhe e dërgon atë për miratim. [Evidenca 89 FE Orari Mësimor.pdf; Aneks nr 57 Ngarkesa totale ne auditor e

	<i>studenteve per format e mesimdhenies ne programin e studimin finance.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]</i>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Sipas aktit të licensimit, Urdhër Nr.16, datë 19.01.2017 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor në Financë, me profile Kontabilitet e Bankë, (Aneks 53) emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve /moduleve dhe e praktikave, për këtë program studimi u mundëson studentëve marrje të njohurive, aftësive, kompetencave të duhura.</p> <p>Departamenti Financë Bankë për realizimin e misionit e përgatitjes së brezave të profesionistëve në fushën e ekonomisë, përmes programit të studimit Bachelor në “Financë”, profilet “Kontabilitet” e “Bankë”, përveç bashkëpunimeve me programin Erasmus, i kushton kujdes aktiviteteve ekstrakurrikulare të studentëve si: vizita në kompani të ndryshme të sektorit publik; leksione të hapura me specialistë të njohur të fushave; pjesëmarrje në konkurse të biznesit; organizim e pjesëmarrje në konferenca shkencore në UMT e më gjerë. Të gjitha këto veprimtari në kuadrin e programit të studimit u krijojnë mundësi studentëve që pas përfundimit të ciklit të parë të gjejnë mundësi punësimi. <i>[Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilit-1.pdf; Aneks nr 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf]</i></p>
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional.	<p>Sipas dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ-ja konstaton se UMT harmonizon shpërndarjen e lëndëve dhe praktikës mësimore në semestra për të arritur objektivat formues të programit të studimit për sa i përket rezultateve të të nxënimit dhe aftësimin profesional të studentëve. Këto rezultate të arritura për këtë program studimi, si në terma të mësimnxënies dhe në ato të aftësimin profesional bëhen cdo vit pjesë e analizave dhe raportimeve, sipas Raportit vjetor të aktivitetit mësimor, kërkimor. <i>[Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilit-1.pdf; Aneks nr 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf; Evidenca 73 FE Raporti vjetor i aktivitetit mesimor, kerkimor dhe financiar FE.pdf]</i></p>
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<p>Organizimi i këtij program studimi (i sqaruar në kriteret më lart të këtij standarti) qysh në fillimet e tij është krijuar duke qenë në koherencë me kriteret e “Kartës së Bolonjës”, standartet institucionale dhe programore që aplikohen në tërë hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. Sipas RVB-se struktura e programit të studimit merr parasysh dhe vlerëson dobinë që ka për studentët përmbajtja e lëndëve duke patur parasysh që studentët do të hasen në punën e tyre me situata nga më të ndryshmet, por edhe do punojnë në një ekonomi globale e konkurruese. Pra, dhe programet duhet t’i përshtaten këtyre zhvillimeve. Struktura e programit mësimor, ngarkesa e shprehur ne kredite dhe raporti teori praktikë është në përputhje me profilet e programeve të përafërta të ngjashme ndërkombëtare në bachelor. <i>[Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin e ciklit te pare te studimit Bachelor ne Finance me profile Kontabilit-1.pdf, Fq 1-2; Aneks nr 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf; Aneks nr 55 Plani mesimor sipas veprimtarive formuese (A-E).pdf; Raporti i</i></p>

<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p><i>Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 18]</i></p> <p>Raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Sipas RVB dhe Evidencës 124, GVJ-ja konstaton se ky program studimi ndahet në veprimtari formuese të vendosura në raporte optimale në orë e kredite, njohuritë teorike e praktike, për të mundësuar aftësimin e studentëve, për arritjen e objektivave formues.</p> <p>Praktikat profesionale te studenteve dhe trainimet e tyre organizohen, ndiqen e mbikqyren nga zyra e karrieres, pjese e Administrates se UMT, ne bashkepunim me dekanatin dhe departamentin si njesi pergjegjese. Praktikak zhvillohen në institucione të caktuara, sipas marrëveshjeve të lidhura mes tyre dhe institucionit, ndiqen nga departamenti, përmes këshilltarëve të departamentit për praktikak mësimore dhe vlerësohen me nota njëjloj si detyrimet e tjera të studentit. Nëse i referohemi planit mësimor, praktika zhvillohet vitin e 3-të, vlerësohet me 6 kredite, e shprehur në orë është 150 orë punë nën mbikqyrjen e udhëheqësit të praktikës dhe punë e pavarur e studentit. <i>[Evidenca 124 Dokumentacion i praktikës per programin e studimit.pdf; Aneks nr 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 18]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literature të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve apo syllabuset të përfshira në këte program studimi, përditësohen vazhdimisht vecanërisht për literaturën bashkëkohore të detyruar dhe ndihmëse, miratohen në departament para fillimit të vitit të ri akademik. Në këto kushte në fillim të cdo viti, personeli akademik që do përfshihet në mësimdhënie ka detyrimin të dorëzojë syllabus të lëndës përkatëse, të përditësuar. Sipas Ligjit nr 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, propozimet bëhen nga njesia bazë, sic është rasti i syllabuseve, të cilat pasi diskutohen e miratohen në departament, përcillen për miratim në dekanat.</p> <p>Departamenti kujdeset që literature si e detyrueshme dhe ndihmese apo plotësuese te jete sa me koherente. Kriteri kërkon që literature të jetë e 5 viteve të fundit, megjithatë GVJ gjykon se për një treg të vogël si vendi ynë, është pothuajse e pamundur që të bëhen ribotime librash cdo 5-vjet. Kështu, që GVJ gjykon si koherente literaturën e 5-8 viteve të fundit. <i>[Aneks nr 56 Plan programet e lendeve programi Finance.pdf.]</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Financë me profile në formë dhe në përmbajtje që nga viti i parë deri në vitin e tretë, bën harmonizim të mirë të dijeve dhe njohurive teorike me aftësimin praktik të studentëve. Kjo bëhet e mundur për arsye se personeli akademik i këtij program studimi kombinon teorinë me praktikën, përmes kombinimit të orëve të lëksioneve e të seminareve, të formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe të seancave të praktikave të zhvilluara në auditor, sjellja në auditotë e specialistëve të njohur të ekonomisë e financave për të sjellë eksperiencat e tyre; praktikak mësimore pranë bizneseve. Të gjithë këto</p>

	veprimtari formuese, garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive e kompetencave që duhet të fitojnë studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë me profile “Kontabilitet” e “Bankë”. [Aneks nr 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf; Aneksi 57 Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit.pdf]			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Sipas RVB-se dhe vizitës në institucion, si dhe dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ verifikoi se përmbajtja e programeve të studimit mundëson vazhdimin e studimeve apo edhe punësimin e studentëve për t’iu përshtatur kërkesave të tregut, si u përmend edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi. Programi i studimit është ndërtuar në mënyre të tillë që kombinon aftësimin teorik në lëndët e përfshira në program, me shprehitë praktike, me shtrirje kohore, duke plotësuar një numër kreditesh, duke bërë të mundur vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë të studimeve. [Aneks nr 56 Plan programet e lendeve programi Finance.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 18]			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Sipas RVB-se dhe vizitës në institucion, si dhe dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”, kombinon teorinë me praktikën më të përparuar të fushës së financës e kontabilitetit, bankave e institucioneve financiare, me qëllim përdorimin e aftësive të fituara në fakultet me eksperiencat nga praktikën mësimore në këto biznese. Po kështu, nisur nga bashkëpunimi i UMT-së me mbi 43 institucione arsimore e me partnerë të biznesit, garantojnë praktikën profesionale, punësimin e studentëve të këtij program studimi. Nënshkrimi i marrëveshjes me Universitetin e Tiranës, ka mundur shkëmbim të stafëve akademike, shkëmbim të programeve mësimore, por edhe bashkëpunimi për hartimin e programit të studimit sa më bashkëkohor. [Evidenca 42 UMT Plan për rishikimin e programeve mësimore.pdf; Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 10]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Sipas RVB-se dhe vizitës në institucion, si dhe dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ verifikoi se personeli akademik i këtij program studimi Bachelor në Finance me dy profile, qoftë ai efektiv apo me kontratë, i plotësojnë kërkesat ligjore në fuqi, përsa i përket

<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>plotësimin të kriterëve. Personeli akademik i Departamentit Financë Bankë ka këtë përbërje: 8 personel akademik efektiv dhe 20 personel akademik me kontratë. Sipas dokumentit Ngarkesa totale e personelit akademik, rezultojnë se ngarkesa totale vjetore e programit të studimit është 1800 orë, e ndarë në 1410 orë mësimore i realizojnë personel akademik efektiv (PAE) dhe 390 orë i realizojnë personel akademik me kontratë, në përfundim rezultojnë që rreth 78 % e ngarkesës mbulohe nga personel akademik efektiv dhe rreth 22% mbulohe nga personel akademik me kontratë. Personeli akademik mbulon mesatarisht 4 lëndë (2 lëndë në cdo semestër, në të gjitha programet e studimit) është i ngarkuar me rreth 200-300 orë në vit.</p> <p>GVJ-ja gjykon se referuar këtij numri të lëndëve, si dhe numrit relativisht të ulët të studentëve në këtë program studimi, kjo ngarkesë mësimore nuk çënon realizimin e objektivave të programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar.</p> <p><i>[Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik; Evidenca 66 FE Lista e Plotë e personelit akademik me kohë të plotë, me kohë të pjeshme FE.pdf; Aneks nr 61 CV te personelit.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Financë dhe Kontabilitet.pdf, fq 20]</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në CV e personelit akademik rezultojnë që niveli i kualifikimit dhe fusha akademike kërkimore përputhet me vecoritë e moduleve që përmbledh ky program studimi. Personeli akademik i angazhuar për mësimdhënie në këtë program studimi, ka eksperiencë në fushën akademike, në kërkimin shkencor, janë ekspertë të fushës së financës apo bankës, manaxherë, drejtorë drejtues biznesesh apo specialistë që punojnë në biznese apo institucione.</p> <p>GVJ-ja bazuar në RVB, vlerëson se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile: “Kontabilitet” e “Bankë”, në Universitetin Metropolitan Tirana, plotëson kriteret ligjore për kualifikimet në fushën akademike kërkimore të përgjithshme dhe specifike. <i>[Aneks nr 61 CV te personelit.pdf; Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Financë dhe Kontabilitet.pdf, fq 20]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Njesia bazë përgjegjëse për këtë program studimi përcakton një apo disa personel akademik si drejtues të praktikave mësimore për të ndjekur studentët gjatë gjithë kohës së kryerjes së praktikave. Si është përmendur në standartin II.4, Departamenti Financë Bankë ka caktuar tre personel akademik jo vetëm për ndjekjen e studentëve në praktikë, por edhe për punimin e diplomës apo veprimtari të tjera specifike. <i>[Tabela 5 Institucionet dhe organizatat në rang programi; Evidenca 22 UMT Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf; Evidenca 8IVendim per percaktimin e koordinatorëveve programeve studimore ne FE.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit</p>	<p>Fakulteti Ekonomisë në Universitetin Metropolitan Tirana, sipas strukturës organizative, siguron e garanton angazhimin e personelit</p>

<p>ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>ndihmës mësimor e shkencor për realizimin e orëve të laboratorit dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mesimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Angazhimi i personelit akademik dhe personelit ndihmës mësimor shkencor është i vazhdueshëm në funksion të realizimit dhe mbarëvajtjes së praktikave laboratorike dhe profesionale.</p> <p><i>[Evidenca 51 FE Struktura, organigrama FE.pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Duke iu referuar dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, ne RVB dhe informacionit të marrë gjatë takimit ne UMT, GVJ konstaton se në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Financë me dy profile, jepen të gjithë elementët e mësimdhënies dhe kontrollit të dijes, përfshirë dhe metodat e mësimdhënies. Në varësi të specifikave të cdo lënde i gjithë personeli akademik nxitet të përdorë metoda bashkëkohore dhe inovative për realizimin e procesit mësimor, që nga përfshirja e të ftuarve specialë nga fusha të ndryshme, për tematika të vecanta, e deri tek përdorimi i videove me situata e koncepte specifike për të ilustruar çështje të caktuara. Studenti është në qendër të procesit mësimor, përmes zbatimit të këtyre metodave.</p> <p>Për t'iu pergjigjur situatës së pandemisë së Covid-19, UMT trainoi stafin për të përdorur platforma si Edu4school, e në këtë mënyrë u zhvillua mësimi online pa ndërprerje e në zbatim të strukturës mësimore. Përveç Edu4school edhe Google education, Google classroom, etj. apo dhe platforma e manaxhimit të institucionit, u përdoren në mbështetje të procesit të mësimdhënies për të gjitha lëndet e programet e studimit të FE, UMT. <i>[Evidenca 103 FE Nderfaqe classroom e një pedagogu.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 21]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Sipas takimit në institucion me Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), konstatohet se kjo njesi funksionon në bazë të Rregullores së UMT, e cila bashkrëndon punën me departamentet përkatëse e strukturat e tjera brenda fakultetit që organizojnë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim nxënies në të gjithë elementet e tij si: në leksione, seminare, laboratorë dhe praktika mësimore. Disa instrumente të kontrollit të monitorimit të mësimdhënies e mësimnxënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i mësimdhënies në auditor, nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektor dhe asistente lektor nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani; • Hartimi i planit të punës për cdo personel akademik nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të vitit, duke e konsideruar si kontratë të performancës për personelin akademik. Mbi këtë bazë do të bëhet vlerësimi i personelit akademik në fund të vitit. Në këtë plan pune përfshihen të gjithë elementet e procesit mësimor, kërkimor e administrativ; <p>NJSBC i paraqit rezultatet e monitorimit të performancës Senatit akademik me raportin e vlerësimit semestral brenda 15 ditëve nga përfundimi i semestrit;</p> <p>Për vlerësimin e performancës së personelit akademik i kushtohet</p>

	<p>rëndësi vlerësimit nga studentët, krahas vlerësimeve nga drejtuesi i departamentit. Përmes sondazhit merret mendimi i studentëve për performancën akademike të personelit mësimdhënës.</p> <p>[Evidenca 9 UMT Rregullore e NjsBC.pdf; Evidenca 10 UMT Analiza e NjsBC për pyetësorët e personelit akademik.pdf; Aneksi 122 Shembull Evidence Plan Monitorimi per mesimdhënien.pdf]</p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultojnë se Departamenti i Financë Bankë në UMT-se i jep rëndësinë e duhur përfshirjes së studentëve në manaxhimin e tërë procesit mësimor, veçanërisht në vlerësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p>Perfshirja e studentëve realizohet përmes përfshirjes së tyre në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e procesit të mësimdhënies, si edhe në procesin e diskutimit të rezultateve të kontrollit periodik të mënyrës së realizimit të leksioneve e seminareve, që realizohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me NJSBC, me pedagogët dhe studentët e grupit, një ose dy here në vit për çdo pedagog.</p> <p>Vlerësimet e studentëve për mësimdhënien në vitin akademik 2019-2020 është pozitiv.</p> <p>Ankesat e studenteve për rezultatet e vlerësimit në provime, mund të shqyrtohen sipas një shkalle hierarkie të caktuar në Rregulloren e provimeve. [Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Evidenca 122 FE Shembull plan monitorimi për mësimdhënien.pdf; Evidenca 115 UMT Proçeverbal i kontrollit në auditorë.pdf]</p>								
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH” Nr 80/2015, për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies njihet si strukturë përgjegjëse NJSBC. Rregullat e detajuara të funksionimit të NJSBC përcaktohen në Statutin e UMT-së. Rezultatet e përpunuara të pyetësorëve, NJSBC-ja i dërgon të diskutohen në Dekanat, Rektorat, e më pas ju komunikohen studentëve dhe personelit akademik problemet e evidentuara dhe masat që ka marrë Rektorati dhe Dekanati për të ardhmen. Kjo procedurë e ka rritur përgjegjësinë dhe cilësinë e punës së pedagogëve, të mësimdhënies, të infrastruktures, etj. [Evidenca 1 UMT Statuti i UMT.pdf; Evidenca 73 FE Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf]</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ u informua nga takimet me drejtuesit e UMT, me personelin akademik të njesisë bazë, se në mbledhjet ku analizohen rezultatet e anketimit, diskutohen praktikat më të mira. Këto analiza ndihmojnë personelin akademik për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, për të përditësuar literaturën, për të përsosur mjetet që do përdoren për mësimdhënie, për të rishikuar strukturën e temave të çdo lënde, si dhe kërkesat për rritje të numrit të pedagogëve. Plani i hartuar nga njesia bazë për monitorimin e procesit të mësimdhënies, përmes vizitave në auditor është shembull i mirë, që ndihmon mësimdhënie cilësore, përgatitje të kujdesëshme të leksionit dhe të komunikimit me auditorin. [Evidenca 123 FE Axhenda e Keshilltarve Akademik sem.II online.pdf; Evidenca 122 FE Shembull plan monitorimi për mësimdhënien.pdf; Evidenca 85 UMT Format pyetësori studenti dhe analizë.pdf]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ vëren se në format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë paraqitur në Rregulloren e programeve të studimit të UMT-së, në nenin 27. Aty janë të përcaktuara elementët e studimeve dhe format kryesore të mësimi, në auditor si: leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, provimet pjesore, provimet përfundimtare, provimet e formimit, projektet e kursit dhe temat e diplomave. <i>[Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf; Evidenca 54 Plani mesimor i programit te studimit Bachelor ne Finance pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentin Analiza e NjSBC për pyetësorët e personelit akademik, konstaton se personeli akademik i këtij programi studimi i përgjigjet nevojave të studentit dhe kushteve specifike (sic ishte rasti gjatë periudhës së pandemisë së Covid kur mësimi u zhvillua on line me platformat Google Classroom apo Edu4school). Personeli akademik duke marrë parasysh natyrën specifike të programit të studimit, ka përdorur metoda të larmishme të mësimdhënies edhe përmes rrugëve elektronike. Në Planin mesimor parashikohen lënde praktike që trajtohen në rrugë elektronike, si në vitin e tretë të studimit, lënda Sisteme Kompjuterike të kontabilitetit, e cila zhvillohet në laborator, pasi janë instaluar nëpër kompjuterë softëare kontabël. Po kështu, personeli akademik zhvillon edhe leksione, seminare në rrugë tradicionale. Përmes trajtimit teorik dhe nga pikpamja praktike të lëndeve u krijohet mundësia studenteve t njohin fushen e kontabilitetit, bankave, institucioneve financiare e në tërësi fushën e ekonomisë. NJSBC-ja hartoi pyetësorin për tërheqjen e mendimit të studentëve mbi cilësinë e mësimi online si nje forme alternative e zhvillimit te mesimit. Rezultatet e këtij pyetësori ende nuk janë bërë objekt diskutimi. Ky ishte konstatimi që doli nga takimi. <i>[Evidenca 10 UMT Analiza e NjSBC për pyetësorët e personelit akademik.pdf; Evidenca 54 Plani mesimor i programit te studimit Bachelor ne Finance. Pdf;Evidenca 102 Raporti per metodat inovative ne procesin e mesimdhënies.pdf; Evidenca 103 FE Nderfaqe classroom e nje pedagogu.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ nga takimet me personelin akademik konstaton se UMT-ja e mbështet personelin akademik për të zhvilluar e përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme kompetencat didaktike Ehtë përmirësuar vitet e fundit mësimdhënia, duke i krijuar mundësi të ushtrojnë lirinë akademike personelit akademik të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë. Ata nxiten nga UMT, të përdorin krahas metodave tradicionale edhe ato bashkëohore si video të shkurtra shpjeguese te koncepteve ose te rasteve studimore nga praktika. Sipas Raportit për metoda innovative, fq.1, personeli akademik, përdor metoda të mësimi nëpërmjet hetimit, si strategji e mësimdhënies përmes së cilës studentët mësojnë më mirë kur i ndërtojnë vetë njohuritë që ju duhen. Edhe eksperiencat e fituara</p>

	<p>përmes shkëmbimeve me universitete të huaja ndikojnë pozitivisht tek mësimdhënia, tek metodat e shumëllojshme e fleksibël pedagogjike. [Evidenca 25 UMT Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për personelin akademik në kuadër të erasmus+.pdf; Evidenca 102 Raporti për metodat inovative në procesin e mesimdhënies.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë”, profilet “Kontabilitet” e “Bankë” ka eksperiencën e duhur akademike, pasi në pjesën më të madhe janë ekspertë në fushën e tyre specifike për të cilën japin leksione e seminare. Personeli akademik jo vetëm ka eksperiencën e duhur akademike, por kanë edhe një bazë të mirë në ushtrimin e profesionit, në praktikën kombëtare e ndërkombëtare, duke e sjellë ekspertizën e tyre në auditor. [Aneks nr 61 CV te personelit.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 24]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ bazuar në raportin RVB e në takimet në institucion, konstaton se në UMT diskutohet në mënyrë të vazhdueshme në njësitë bazë rreth përmirësimit të metodave të mësimdhënies, për të përfshirë sa më shumë studentët në diskutime.</p> <p>Pas analizës së rezultateve të pyetësorëve nga NjsBC, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi në reflektim të këtyre analizave përmirëson metodat e mësimdhënies, gjatë zhvillimit të lëndës ose në përfundim të saj, në varësi të ecurisë së studentëve. Në këtë mënyrë studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të mësimdhënies.</p> <p>Edhe këshilltarët akademike, (dy nga Departamenti i Financë Bankë), janë më afër studentëve të secilit grup. Të gjitha problemet kalojnë më pas në njësinë bazë, dekanat e rektorat nëse është e nevojshme.</p> <p>Sugjerimet lidhur me mësimin, raporti teori praktikë, mënyrat e vlerësimit, etj, janë zgjidhur duke ndryshuar rregulloren nëse është parë e nevojshme apo duke përmirësuar metodën e punës nga drejtuesit e stafi akademik. [Evidenca 49 UMT Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 25; Evidenca 10 UMT Analiza e NjsBC për pyetësorët e personelit akademik.pdf.]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Zhvillimi i leksionit në mënyrë interaktive, është një metodë mësimdhënie e përdorur nga personeli akademik i programit të studimit. Sic e përmendëm në kriterin e mësipërm Metodave Innovative të mësimdhënies, mësimi përmes hetimit, ilustron atë që përmendëm më lart. Në UMT është në qendër studenti, për këtë arsye konceptimi i procesit mesimor është bere në këte funksion. Ka patur ndryshime nga metoda tradicionale e mesimdhënies, duke i dhënë me shume mundesi pjesmarrjes aktive të studentëve në auditor me pyetje e diskutime. Sjellja në auditor e profesionistëve të fushës për ceshtje të caktuara i afron studentet me realitetin e bizneseve tona. Edhe eksperiencat nga universitete të huaja, kryesisht mobilitete të pedagogëve me projekte Erasmus +, kanë nxitur të punuarit për metoda të reja të mësimdhënies. [Evidenca 25 UMT Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për personelin akademik në kuadër të erasmus+.pdf; Evidenca 27 UMT Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit, mobilitetit.pdf; Metodave innovative te mesimdhënies.pdf, fq 1]</p>

<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Financë, nxit mendimin kritik të studentëve, përmes tërheqjes së tyre në diskutim gjatë zhvillimit të mësimi, përmes përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies. Kjo arrihet duke i dhënë detyra për t'u përgatitur në mënyrë individuale ose në grup studentëve dhe më pas i lihet kohë studentit apo grupit të studentëve të diskutojnë gjetjet e tyre në klasë. Nga takimi me studentet përforcoam mendimin se janë përdorur metoda të reja bashkohore mësimdhënie, që nxisin mendimin e pavarur, krijojnë lirshmëri në komunikimin me studentët. Edhe eksperiencat nga universitete të huaja kanë nxitur të punuarit për metoda të reja të mësimdhënies. [Evidenca 26 UMT Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për studentët në kuadër të erasmus+.pdf]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.3</p>	
<p>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Veprimtaria mësimore e shkencore e UMT realizohet në hapësira të mjaftueshme të pajisura me mjete dhe pajisje didaktike moderne. Disponon dy godina në Qytetin Studenti në Rruga “Budi”, të cilat krijojnë mundësi për zhvillimin e procesit mesimor me të gjitha standartet ndërkombetare. Godinat janë të pajisuar me sistem ngrohje ftohje në tërë ambientin. GVJ, nga vizita në institucion konstaton se në UMT plotësohen kushtet për zhvillimin normal të mesimit dhe të gjithë aktivitetit kërkimor e shkencor. [Evidenca 107 FE Ambientet për infrastrukturën të UMT FE.pdf; Evidenca 108 FE Asete infrastrukturore, akademike UMT.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Pas vizitës në institucion u verifikua se të gjitha sallat e leksioneve e seminareve janë të pajisura me kompjutera e laptopë, projektorë, tabela të ndryshme për të shkruar pedagogu apo studentet. Në të gjitha mjediset sigurohet lidhja e internetit EIFI. Kjo bën të mundur zhvillimin e mësimi on line me video për tema të caktuara. Krijohet mundësi për të zhvilluar mësimin me kompjutera për lëndë specifike si informatika, kontabiliteti etj. GVJ konstaton se mjedisi i bibliotekës nuk ofronte hapësirën e duhur për libra e as për të shtuar tituj të rinj për të cilët ka nevojë ky program studimi. Në të njëjtën kohë theksojme se nuk ofrohet hapësira e nevojshme edhe për të akomoduar studentët brenda bibliotekës. [Evidenca 107 FE Ambientet për infrastrukturën të UMT FE.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të</p>	<p>Personeli akademik ka vendin e tij të punës të mirëpajisur. UMT ka në funksionim sistemin e manaxhimit të të dhënave, që nga viti 2012, i</p>

<p>ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>përditësuar në vitin 2019-2020, periudhë në të cilën përdor platformën edu4school. Sistemi mundëson manaxhim të integruar të të dhënave për programet akademike, kurrikulat, personelin akademik dhe studenteë. Ky sistem manaxhon në kohë reale lidhjen interaktive student/pedagog, sillabusin e lëndës dhe materialet mësimore të hedhura nga pedagogu (leksione, materiale të ndryshme), frekuentimin e studentit lëndë/module, vlerësimet e studentit (vlerësim i vazhduar dhe ai përfundimtar) etj. Edhe studentët kanë akses në çdo kohë në sistem për të parë informacion lidhur me vlerësimin, mungesat, detyrimet për çdo lëndë etj. Sistemi informatik përdoret nga stafi akademik dhe studentët për kërkimin shkencor.</p> <p><i>[Evidenca 43 UMT Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf; Evidenca 48 UMT Platforma për mësimin online.pdf; Evidenca 63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita ne institucion dhe takimi me studentët rezulton se ata kanë akses në të gjithë literaturën në dispozicion në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze, por dhe në gjuhë të tjera të Bashkimit Europian. Literatura përbëhet nga libra, revista, botime të autorëve shqiptarë e të huaj, libra të përkthyer.</p> <p>GVJ mendon se ende ka nevojë për libra si fond fizik, vecanërisht për lëndet që zhvillohen në kete program studimi. <i>[Evidenca 109 FE Relacion biblioteke dhe laborene informatike UMT FE.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka mundëson aksesin në libraritë online si për personelin akademik edhe për studentët. Stafi i bibliotekës ofron mbështetje studentëve për gjetjen e burimeve on line. Biblioteka është e pajisur me kompjuterë, që tû krijojë mundësi studentëve të lexojnë qoftë në bibliotekë duke huazuar librat sipas rregullores së bibliotekës apo duke përdorur kompjuterat për të hyrë në libraritë dixhitale përmes faqeve on linë të vëna në dispozicion nga UMT. Në RVB shkruhet se studentët kanë akses të pakufizuar tek disa adresa të bibliotekave elektronike. <i>[Evidenca 44 UMT Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve.pdf; Evidenca 45 Ndërfaqja, administratori, pedagogu, sekretaria, studenti.pdf; RVB fq 27; Tab 17 Te dhena per platformat online.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, Evidencës 16 Mjediset e FE, ekziston infrastruktura laboratorike, e konkretisht dy laboratorë për lëndët dhe dy laboratorë informatike. Laboratorët janë të pajisur me kompjuterë që kanë të instaluar softëare në përputhje me specifikat e programit të studimit Bachelor në "Financë" me dy profile: "Kontabilitet" dhe "Bankë". Për përgatitjen e detyrave të kursit, projekteve, diplomave, studentët mund të përdorin kompjuterat që ndodhen në laboratorë apo në bibliotekë. <i>[RVB per programin e studimit Bachelor në Financë me dy profile Kontabilitet Bankë fq.28; Evidenca 109 FE Relacion biblioteke dhe laborene informatike UMT FE.pdf; Evidenca 16 Mjediset e Fakultetit Ekonomisë për Programin e studimit.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Sipas RVB, Evidencës 16 Mjediset e FE, ekziston infrastruktura laboratorike, e konkretisht dy laboratorë për lëndët dhe dy laboratorë informatike. Laboratorët janë të pajisur me kompjuterë që kanë të instaluar softëare në përputhje me specifikat e programit të studimit Bachelor në "Financë" me dy profile: "Kontabilitet" dhe "Bankë". Për përgatitjen e detyrave të kursit, projekteve, diplomave, studentët mund të përdorin kompjuterat që ndodhen në laboratorë apo në bibliotekë. <i>[RVB per programin e studimit Bachelor në Financë me dy profile Kontabilitet Bankë fq.28; Evidenca 109 FE Relacion biblioteke dhe laborene informatike UMT FE.pdf; Evidenca 16 Mjediset e Fakultetit Ekonomisë për Programin e studimit.pdf]</i></p>

<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ bazuar në raportin RVB e dokumentacionin që është përcjellë nga IAL, DVV, konstaton se UMT-ja përdor sistemin interaktiv online (Sistemi i Manaxhimit të Studenteve) që i shërben studentëve për të marrë informacion për notat, për të komunikuar me stafin, për të lexuar materiale mësimore, për ecurinë e pagesave, për eventet e UMT-se. Sistemi i shërben edhe personelit akademik për të hedhur nota, për të komunikuar e hedhur materiale për studentët, për të komunikuar me strukturat e UMT-së.</p> <p>Për të mbështetur procesin mësimor në UMT kombinohet forma e mësimimit në auditor me formën jashtë tij, përmes platformës së sistemit të teknologjisë elektronike “edu4schools”. UMT aplikon mesimdhënien në distancë, përmes platformës GotoMeeting, vecanërisht në periudhën e pandemisë së Covid-19. [Tabela 17. Te dhena te plota per platformat online.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 28]</p>				
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Sipas RVB, sipas takimeve në UMT, personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemin informatik që disponon UMT-ja. Sistemi edu4schools është instaluar në tërë njësitë e strukturat përbërëse të UMT-së. Përvec këtij sistemi, ata përdorin edhe platformen “GotoMeeting- GTM” si dhe platforma të tjera testimesh (google drive) ofruar nga institucioni me akses nëpërmjet adresave personale të email (emer.mbiemer@umt.edu.al).</p> <p>Përmes platformave studentët marrin informacion për mësimin, vlerësimin e provimeve, komunikojnë me sekretarinë, etj. [Tabela 17. Te dhena te plota per platformat online.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 28]</p>				
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Nga informacionet e marra nga studentët dhe nga personeli akademik, si dhe përmes dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, rezultoi se të gjithë studentët kanë zhvilluar një provim përfundimtar e jo mbrojtje të diplomës në përfundim të studimeve të tyre. Nëse studentët duan të bëjnë mbrojtje teme diplome në fund të vitit të tretë, duhet të bëjnë kërkesë në department bazuar në Rregulloren e Procesit Mësimor dhe Rregulloren për Përgatitjen e Temës së Diplomës.</p> <p>Në rregulloren e UMT-së në nene të ndryshme mbi format e kontrollit të dijës, shprehet se cikli Bachelor mbyllet me provim apo me diplomë.</p> <p>Mendojme se pavarësisht se në gjithë rregulloret dhe dokumentat institucionale e parashikojnë këtë të drejtë, edhe nga takimi me studentët rezultoi se një pjesë e tyre dëshironin të mbronin temë diplome, por institucioni vendosi se të gjithë studentët do të zhvillonin një provim përfundimtar. Mendojmë se studentëve duhet t’u jepet mundësia të përgatisin diplomë në fund të vitit të tretë, vecanërisht studentëve me rezultate të mira. [Evidenca 63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf; Aneks nr 64 Proçedura e pergatitjes dhe mbrojtjes se diplomes.pdf]</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="582 1800 726 1863">Niveli i përmbushjes</td> <td data-bbox="730 1800 933 1863">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="938 1800 1141 1863">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1145 1800 1359 1863">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

standardit			X	
------------	--	--	---	--

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ-ja, bazuar në raportin RVB-se dhe dokumentacionin që është përcjellë nga IAL, DVV, konstaton se UMT-ja ka ngritur strukturën e përmirësimin të vazhdueshëm të mësimdhënies, Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC në nivel institucional, e cila bashkërendon punën me njësitë bazë. Në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Departamenti Financë Bankë, në Fakultetin e Ekonomisë të UMT, përcakton koordinatorët (Këshilltarët akademikë), të cilët në bashkëpunim me NJSBC mbikqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikqyrja bëhen edhe nga njesia kryesore në bashkëpunim me NJSBC-në. Këto njesi bëjnë përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie e mësimnxënie.</p> <p>Të gjitha strukturat e UMT-së mbështesin përmirësimet e vazhdueshme të mësimdhënies, përfshi metodat e reja inovative të tyre. <i>[Evidenca 7 UMT VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf. fq 29]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njesia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti Financë Bankë është njesia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Financë”, me dy profile: “Kontabilitet” e “Bankë”. Këto përgjegjësi janë përcaktuar në Statutin e UMT dhe në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë. Njesia bazë është njesia ku nisen propozimet, pasi diskutohet, për çdo element që ka lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programit të studimit. Njesia bazë dhe strukturat e tjera të UMT nxisin studentët të jenë pjesë e procesit të evidentimit dhe përmirësimin të cilësisë në mësimdhënie. <i>[Evidenca 1 Statuti i UMT.pdf; Evidenca 50 FE Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Njesia bazë ka rolin kryesor në promovimin e mbështetjen e metodave të reja inovative të mësimdhënies, por duke u mbështetur edhe nga strukturat e tjera në nivel fakulteti. Të gjitha strukturat e Fakultetit të Ekonomisë dhe të UMT, duke ndjekur e zbatuar politikën e strategjitë e tyre inkurajojnë personelin akademik të zhvillojë metoda të reja mësimdhënie. Në lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, këto metoda fokusohen kryesisht në kryerjen e leksioneve nga specialistët më të mirë të fushës nga brenda apo jashtë fakultetit, nxitjen e punës në grup të studentëve, në analizën e rasteve studimore etj. Nga ana tjetër personeli akademik mund të zhvillojë mësimin me anë të mjeteve vizuale, laboratorëve, për të ndihmuar mësimdhënien e lëndëve specifike që kërkojnë përdorimin e teknologjisë. <i>[Evidenca 49 UMT Udhëzimi mbi</i></p>

	<i>mësimdhënien në distancë.pdf; Evidenca 102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësidhënies.pdf]</i>
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Personeli akademik i programit të studimit, plotëson kriteret për kualifikim si përmes kërkimeve e studimeve brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit. Kualifikimi jashtë vendit kryhet përmes studimeve të ndryshme afat shkurtër apo afatgjatë, si dhe përmes programeve të mobilitetit të pedagogëve. Për këtë qëllim UMT-ja ka lidhur marrëveshje me organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe ka realizuar projekte mobiliteti, përmes programit ERASMUS+.</p> <p>Sipas RVB fq 29, Personeli i UMT-se është i angazhuar me kërkimin shkencor i financuar nga vetë UMT-ja dhe nga projekte ndërkombëtare, si psh., “Smart Marketing”, i cili ka mbështetur disa pedagogë të vjetër e të rinj për t’u përshtatur me metodat e reja dixhitale e inteligjente të mësimdhënies e të drejtimit të biznesit.</p> <p>Njesia kryesore e njesia bazë kanë organizuar edhe aktivitete kërkimore shkencore si seminare e konferenca. <i>[Evidenca 27 UMT Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit, mobilitetit.pdf; Raporti i Vleresimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 29]</i></p>
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>Sipas RVB-së, i gjithë personeli akademik i këtij program studimi, i është përditësuar me metodat e reja inovative të mësimdhënies, të cilat i pasqyrojnë në përmirësimin e kurrikulave, por edhe të metodave të mësimdhënies. Gjatë këtij procesi përmirësimi ata mbështeten nga njesitë bazë dhe hallkat e tjera të strukturës organizative të njesisë kryesore apo në nivel institucioni. Në shërbim të këtij procesi përditësimi kanë qenë dhe aplikimet për projekte që kanë patur si qëllim shkëmbimin e stafit dhe të studentëve. Si platformë që u krijon mundësi pedagogëve dhe studentëve për mësim të personalizuar, po punohet për projektin Moodle. <i>[Evidenca 24 UMT Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese.pdf; Raporti i Vleresimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 30]</i></p>
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	<p>Angazhimin për zbatimin e programeve të studimeve, për përmirësimin e mësimdhënies e përdorimin e metodave të reja, personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Financë”, me dy profile: “Kontabilitet” e “Bankë”, e fillon me nënshkrimin e kontratës së punës nga UMT. <i>[Evidenca 68 Te dhena statistikore të personelit akademik PAE PAK.pdf]</i></p>
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p>Sipas RVB-së, dhe dokumenteve të tjera si Raporti vjetor i aktivitetit mësimor kërkimor, gjetja e përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies janë përparësi për të gjitha strukturat e UMT-së, në vecanti për NJSBC. Për të përmirësuar punën, janë organizuar seminare, leksione të hapura, konsultime, ëorkshope etj. Këto metoda të reja janë bërë të njohura për të gjithë stafin e UMT-së me qëllim gjetjen e mbështetjes nga të gjitha strukturat për të realizuar këtë objektivi. Nga vizita në institucion rezultoi se në periudhën e pandemisë Covid – 19, përmes teknologjive e platformave të përshtatshme personeli akademik e ai ndihmës akademik, iu përgjigjen mësimdhënies online, në përputhje me strukturën mësimore të miratuar. <i>[Evidenca 73 FE Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf; Evidenca 102 FE Raporti</i></p>

	<i>për metodat inovative në procesin e mësidhënies.pdf; Evidenca 48 UMT Platforma për mësimin onlin.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 30]</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësiwe profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ-ja konstaton, pas shqyrtimit të dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV dhe vizitës në institucion, se kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, aftësiwe, kompetencave profesionale vendosen në: Rregulloren e përgjithëshme e UMT-së, Rregulloren e Provimeve, Rregulloren për Programin e Studimit. Në rregulloren e provimeve përcaktohet sistemi i vlerësimit me notë të studentit, dhe shërben si orientim për strukturën e këtij vlerësimi. Studentët njihen me rregulloren qysh në fillim të vitit akademik, duke mësuar të drejtat dhe detyrimet e tyre. <i>[Evidenca 58 Rregullore e programit të studimit; Evidenca 2 Rregullore e UMT; Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf]</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në syllabuset e lëndëve përcaktohet në mënyrë të detajuar struktura e vlerësimit të secilës lëndë. Sistemi specifik i vlerësimit për cdo lëndë i bëhet i ditur studentit qysh në orën e parë të prezantimit të lëndës nga pedagogët, së bashku me elementet e tjerë të zhvillimit të lëndës si: detyrat e kursit, testi i ndërmjetëm, testi përfundimtar, vlerësimi me pikë i cdo detyrimi etj. Ky informacion për vlerësimin e lëndës saktësohet edhe në Rregulloren e UMT, Rregulloren e Programit të Studimit, Rregulloren e provimeve. <i>[Evidenca 2 Rregullore e UMT.pdf; Evidenca 58 Rregullore e programit të studimit; Evidenca 2 Rregullore e UMT; Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Tabela 14. Model Syllabus.pdf]</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV dhe vizitës në institucion, konstaton se për të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, struktura e vlerësimit të tyre është e përbërë nga disa elemente si: pjesëmarrja aktive, provime të pjesëshme, paraqitje të detyrave apo gjetjeve në klasë, projekte individuale apo në grup, provime përfundimtare etj. Struktura mund të ndryshojë nga lënda në lëndë në varësi të specifikave të saj. Në cdo rast, struktura e lëndës mundëson vlerësimin e studentëve bazuar në disa elemente në përputhje me Rregulloren për programet e studimit, duke i dhënë mundësi studentit të tregojë njohuritë e marra dhe kompetencat e fituara. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, pohime, pyetje shpjeguese, kuptim e zbërthim konceptesh, ushtrime e raste. <i>[Tabela 14. Model Syllabus.pdf; Evidenca 63 FE Procedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf; Evidenca 58 Rregullore e</i>

	<i>programit te studimit; Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>GVJ konstaton nisur nga RVB-ja se kontrolli i dijeve për cdo lëndë është i vazhdueshëm, duke e mbajtur studentin të angazhuar gjatë gjithë procesit të zhvillimit të lëndës. Vlerësimi final i tij përbëhet nga tërësia e vlerësimeve të vazhdueshme të bëra gjatë vitit përmes testimeve apo projekteve finale sipas specifikave të lëndës. Ky vlerësim zakonisht përbëhet nga: 5 % për pjesmarrjen, 5% për aktivizim, 10% detyra kursi, dhe 10% provim i ndërmjetëm, provimi përfundimtar zakonisht është 70%. Të gjitha detyrimet përfshihen në programin apo syllabusin e lëndës.</p> <p>Ky sistem i vlerësimit të njohurive të studentëve, i nxit e i motivon studentët të përgatiten në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit, në auditor dhe në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>[Aneks nr 56 Plan programet e lendeve programi Finance.pdf; Tabela 14. Model Syllabus.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; fq 31]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Kriteret, kërkesat dhe procedurat që shërbejnë për testimin e aftësive të studentëve parashikohen në Rregulloren e UMT-se dhe rregulloret e tjera në plotësim të saj. Në vazhdim të kriterit 1, në ato lëndë në të cilat është e mundur, realizohet testimi i studentëve në mënyrë elektronike si në: Informatikë apo Sistemet e kompjuterizimit kontabël. Në pjesën më të madhe të lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi mësimi zhvillohet nga të paktën dy pedagogë, për leksionin e seminarin dhe si rrjedhim edhe komisionet që testojnë njohuritë e studentëve janë me të paktën dy pedagogë, ku njeri është titullar i lëndës.</p> <p>Testi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive, aftësive dhe kompetencave realizohet nga komisionet e provimeve të ngritura nga njesitë bazë dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit, sic parashikohet nga Rregullorja e UMT-se, Rregullorja e provimeve, Rregullorja e programit mësimor.</p> <p><i>[Aneks nr 58 Rregullore e programit.pdf; Evidenca 63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf; Evidenca 2 Rregullore e UMT.pdf; Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Tabela 14. Model Syllabus.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullar i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi i studentëve, kur bëhet me anë të provimit me shkrim bëhet i sekretuar. Sipas RVB, kontrolli i testeve e provimeve zhvillohet sipas</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim,</p>	<p>Testimi i studentëve, kur bëhet me anë të provimit me shkrim bëhet i sekretuar. Sipas RVB, kontrolli i testeve e provimeve zhvillohet sipas</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 37

<p>zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>rregullave të parashikuara në Rregulloren e provimeve. Format e kontrollit parashikohen në Rregulloren e Provimeve në mënyrë të detajuar dhe zbatohen me kujdes. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Tezat sekretohen nga sekretaria me barkod dhe kontrollohen nga pedagogu pa emra. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatit në fletën e provimit. Provimi nuk zhvillohet asnjëherë pa sekretim, në disa salla ka edhe kamera për monitorim të procesit provimit. UMT-ja përdor dhe sistemin Clean Score për korrigjimin automatik të provimeve, rezultati del në pak minuta. [Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 32]</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, i dijeve i aftësive profesionale, bëhet bazuar në Rregulloren e UMT, në Rregulloren e provimeve. Pavarësisht formës së testimit, studentët kanë të drejtën e ankimit të procesit të vlerësimit. Sipas RVB, nga kontrollet që bëhen gjatë vitit, studentëve u jepen detyra që synojnë të përmirësojnë njohuritë që janë konstatuar të mangëta në provime. [Evidenca 63 FE Procedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf; Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 32]</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Sipas Rregullores provimeve, në UMT procesi i provimit monitorohet nga komisioni i provimit, duke mos lejuar kopjimin e provimeve. Gjithashtu, personeli akademik i cdo lënde është i kujdesshëm për të eliminuar këteëproblem edhe në detyrat apo projektet e kursit. Sipas RVB, njesitë bazë dhe personeli akademik respektojnë Rregulloren e Provimit dhe Kodin e Etikës lidhur me mënyrën e mbikqyrjes dhe të masave ndeshkuese në rast kopjimi gjatë procesit të provimit ose plagjiaturës në rast kopjimi të projekteve të kursit etj. [Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 32]</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga takimi në institucion, u njohëm me faktin se korrigjimi i provimeve kryhet nga pedagogu/ët e lëndës, brenda një afati si rregull, jo më shumë se 1 javë nga dita e provimit dhe rezultatet dorëzohen në sekretarinë mësimore. Sipas RVB, Sekretaria mësimore njofton në mënyrë konfidenciale me email studentët për rezultatet e provimeve brenda një afati 3 ditor nga dorëzimi i rezultateve nga ana e pedagogëve të lëndës. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit, teza depozitohet në departament. [Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 33]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Rregullores për Programin e Studimit, studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit të provimit brenda një afati 48 orësh nga dhënia e njoftimit dhe ankimi i njoftohet menjëherë pedagogut të lëndës. Mbas kësaj faze nëse studenti nuk bindet, atëherë ka të drejtën e ankimit në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet nga një komision i vecantë. [Evidenca 127 FE Shembull Ankimim note.pdf; Aneks</p>

	nr 58 Rregullore e programit.pdf]			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Cdo kerkese apo ankimim shqyrtohet nga komisioni fillestar prej të paktën dy pedagogësh, duke respektuar Rregulloren e Provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve ne UMT. [Evidenca 63 FE Procedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf; Evidenca 127 FE Shembull Ankimim note.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nisur nga RVB-ja se programi i studimit Bachelor në “Financë” me profilet “Kontabilitet” e “Bankë” zhvillohet në funksion të marrjes së njohurive të specializuara në fushën e Kontabilitetit. GVJ konstaton se ndarja në dy profile Kontabilitet Bankë në këtë program studimi në praktikë nuk ekziston dhe aktualisht zhvillohet vetëm një profil, ai kontabilitet.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Duke iu referuar edhe takimeve ne institucion, duke parë lëndët që zhvillohen në këtë cikël të studimit, pyetjes së GVJ lidhur me eficiencën e ndarjes së këtij program studimi në dy profile Kontabilitet e Bankë, kur janë vetëm 13 studentë në këtë program, iu dha përgjigje jo shteruese nga ana e institucionit. Pra, duhet të justifikohet, arsyeja e ndarjes në dy profile, ose në planin mësimor duhet të ishte më i kuptueshëm dallimi mes lëndëve të një profili dhe të profilit tjetër. Në kriterin 2 të Standartit II.1 jemi shprehur për ndarjen e programit të studimit Bachelor në “Financë” në dy profile. Shpjegojmë në mënyrë më të detajuar për të argumentuar mendimin tonë si GVJ pas shqyrtimit të Planit Mësimor: Në vitin e tretë kur ndahen profilet, në Profilin Kontabilitet ka: 4 lëndë të kontabilitetit: KKD, Analizë Financiare, Auditim, Sisteme të Kompjuterizuara Kontabël (të njëjta në të dy profilet me të njëjtën peshë në kredite) 3 lëndë të Financës (Investime, Tregje dhe Institucione Financiare ose Financa Personale, Taksim Biznesi) 1 lëndë nga Manxhimi (Manaxhim i Burimeve Njerëzore) Në Profilin Bankë: 4 lëndë të kontabilitetit të njëjta me profilin Kontabilitet: KKD, Analizë Financiare, Auditim, Sisteme Kompjuterizuara Kontabel 4 lëndë të Financës me pak ndryshime vetëm 2 lëndë (Drejtimit Financiar, Financa Publike, Tregje dhe Institucione financiare, Taksim Biznesi). Nëse do të llogarisim kreditet e ndryshuara në

	<p>profilin bankë janë 2 lëndë, 12 kredite/60 kredite. Nëse e llogarit në përqindje, rezulton 20% ndryshon profili Bankë nga ai Financë.</p> <p>Në këto kushte GVJ mendon se nuk justifikohet ndarja në dy profile.</p> <p><i>[Aneks nr 54 Plani mesimor i programit.pdf; Aneks nr 53 Te dhena te pergjithshme mbi programin.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 34 Aneks 56]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti pas përfundimit të cdo lënde, evidentohen në fund të lëndës, kur studenti dorëzon detyrën e kursit apo projektin, apo nëse e mbron lëndën me provim me shkrim, ku studenti duhet t'i përgjigjet pyetjeve jo vetëm teorike, por edhe rasteve studimore. Në këtë mënyrë vlerësohen aftësitë e kompetencat e fitura nga studenti.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Sipas RVB, në përfundim të cdo lënde nga personeli akademik zhvillohet një leksion përmblyës, ku përmbledhen të gjitha temat, duke shpjeguar çështjet kryesore. Studentët pyesin për paqartësi lidhur me lëndën, personeli akademik orienton studentët për përgatitjen e provimit. Për cdo lëndë shpallet orari i konsultimeve.</p> <p><i>[Evidenca 63 FE Procedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf; Tabela 14. Model Syllabus.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 34]</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga RVB-ja dhe takimi me personelin akademik GVJ mësoi se personeli akademik në orët e leksionit fton specialistë nga fushat e financës, teknologjisë së informacionit, ekonomisë në tërësi për të shpjeguar mbi zhvillime të reja të shkencës apo teknologjisë, në shërbim të ekonomisë. UMT-ja si institucion realizon gjatë gjithë vitit seminare të hapura për tema e zhvillime të reja që kanë lidhje me fushën e administrim biznesit, në të cilat kërkohet pjesmarrja e studentëve. Studentët e programit të studimit Bachelor ne "Finance" me dy profile: "Kontabilitet" e "Bankë", shfrytëzojnë këto leksione të hapura, për të plotësuar njohuritë e tyre mbi zhvillimet e reja në fushën përkatëse. Krijohen mundësi për studentët për kryerje praktikash mësimore, për mundësi punësimi në bizneset që janë ofruar për bashkëpunim. <i>[Evidenca 99 FE Lista aktiviteteve, leksione te hapura FE.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 34]</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga takimi me personeli akademik GVJ mësoi se harmonizimi i formimit teorik me aftësimin e njëkohshëm praktik, me zbatimin në laborator të njohurive të marra në lëndë specifike, mundësojnë jo vetëm lidhjen me praktiken profesionale, por edhe punësimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Interaktiviteti, bashkëveprimi me studentët është proces që zhvillohet vazhdimisht në disa lëndë nga personeli akademik, duke dhënë detyra apo raste studimore që nxisin punën e pavarur, përdorimin e laboratorëve. Si shembull mund të merret zgjidhja e situatave reale të mbajtjes së kontabilitetit në lëndën Sistemet e Kompjuterizuara Kontabël (nga vizita në institucion).</p> <p>Në UMT personeli akademik përdor si një nga metodat e</p>

	<p>mësimdhënies diskutimin në grup në orët e mësimit. Kjo rezulton një mënyrë efikase për t'i aktivizuar studentët gjatë zhvillimit të mësimit në auditor. [Tabela 14. Model Syllabus.pdf; Tabela 15. Format e kontrollit te njohurive.pdf; Evidenca 102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësidhënies.pdf]</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Nga RVB vërehet se në Strategjinë e UMT-së përcaktohet se procesi mësimor zhvillohet me në qendër studentin. Nga dokumentacioni që është përcjellë nga IAL, DVV, dhe takimet me personelin akademik rezulton se personeli akademik komunikon në mënyren e duhur me studentët, duke u perpjekur të tërheqë vëmendjen e studentëve gjatë leksionit, përmes videove, rasteve studimore nga praktika, drejtimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve, vlerësimit të tyre. Aktivizimi i studentëve mund të arrihet edhe përmes dhënies paraprakisht të leksionit studentëve për ta studiuar e më pas diskutohet në auditor, përmes përgjigjes së pyetjeve e përqëndrimit në çështjet më të rëndësishme. Personeli akademik nxit idetë e reja, inovative të studentëve duke i mbështetur ata në idetë e tyre për punime kërkimore, apo për t'i paraqitur ato punime në konferenca shkencore. Edhe sjellja në auditor e specialistëve të fushave të ndryshme vendas apo të huaj, në përputhje me temën që do shpjegohet sipas programit, i shërben marrjes se njohurive të reja nga praktika e bizneseve, organizatave etj. [Evidenca 102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësidhënies.pdf; Evidenca 72 FE Lista e lektorve të huaj dhe e aktiviteteve FE.pdf]</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në Rregulloren e UMT, në raportin për metodat inovative në procesin e mësimdhënies, theksohet se studenti është subjekt i punës kërkimore shkencore, që kryen aktivitet krijues krahas personelit akademik. Studentët kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve kombëtare e ndërkombëtare si dhe pranë Universitetit Metropolitan Tirana, për financime të veprimtarive kërkimore shkencore me logon e UMT-se. UMT-ja ka edhe një inkubator të biznesit, i cili ndihmon studentët për anancuar me idetë e tyre krijuese në fusha të ndryshme të biznesit, të teknologjisë së ndertimit, dhe në fusha të tjera të ekonomisë.</p> <p>UMT ka vene ne dispozicion të kërkuesve për të realizuar punët kërkimore, salla e ambiente të ndryshme laboratore informatike, si dhe biblioteken. [Evidenca 102 FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësidhënies.pdf; Evidenca Rregullore e UMT.pdf]</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Sipas RVB e vizitës në institucion rezulton se personeli akademik në UMT punon për të përmirësuar format e mësimdhënies me qëllim rritjen e eficiencës së mësimdhënies e mësimnxënies. Kjo arrihet duke rritur cilësinë e personelit akademik, por edhe duke bashkëpunuar me fakultete, biznese, institucione, për të shkëmbyer ekspertizë. Edhe bashkëpunimet me universitete jashtë vendit, edhe perpjekjet për të shkruar projekte e për të fituar projekte i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, shtimit të mobilteteve të pedagogëve e të studentëve për të marrë eksperiencë që do i ndajnë në auditorë.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që disponon UMT për pjesëmarrjen</p>

	<p>në projekte të huaja, rezulton se raporti projekte të shkruara ndaj atyre të fituara është ende i ulët. Kështu, sipas Evidences 24, për vitin 2019-2020 nga 20 projekte të shkruara, vetëm 4 janë të fituara. GVJ mendon se pjesmarrja në projekte të huaja do rriste mobilitetin e studentëve dhe të personelit akademik, do ndikonte për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. [Evidenca 28 UMT Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT.pdf; Evidenca 24 Lista e projekteve të aplikuar nga UMT dhe projekte fituese.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 36]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimet me studentët e personelin akademik GVJ mësoi se procedura dhe kriteret për diplomimin e studentëve janë saktësuar në Rregulloren për Programin e Studimit dhe Rregulloren e Provimeve. Njesia bazë para se të nisë semestri i dytë i vitit të fundit, njofton studentët me email për t’i informuar për formën e diplomimit dhe afatet përkatëse.</p> <p>Në Fakultetin e Ekonomisë, studentët e Programit të studimit Bachelor në “Financë”, me dy profilet “Kontabilitet” e “Bankë”, në fund të studimeve të ciklit të parë, kanë mbrojtur të gjithë provim përfundimtar e asnjë prej tyre nuk ka mbrojtur temë diplome.</p> <p>Sic e kemi përmendur edhe në kriteret më lart, Rregullorja e programit të studimit neni 14, parashikon se për të fituar diplomën Bachelor në Financë me dy profile: Kontabilitet e Bankë, studenti duhet të mbrojë një punim diplome apo provim formimi. Studenteve duhet t’u krijohet mundësi të përzgjedhin nëse do zhvillojnë provim final apo do përgatisin e mbrojnë diplome. [Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Evidenca 58 Rregullore e Programit të Studimit, fq 8.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti Financë Bankë në bazë të Rregullores së programit të studimit si Njesia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, udhëzon studentët për procesin e diplomimit. Në funksion të mbështetjes që u jepet studenteve, të cilët diplomohen me provim diplome, është dhe udhëzimi për zhvillimin e provimeve të Fakultetit të Ekonomisë, cikli Bachelor. [Evidenca 63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë</p>	<p>Sipas RVB-se, ky është brezi i parë i studentëve të programit të studimit Bachelor në Financë, me dy profile Kontabilitet e Bankë dhe për kryerjen e detyrimeve finale është parashikuar provim për mbrojtjen e diplomës. Ndërsa, sipas Rregullores së programit të studimit, në nenin 14 parashikohet punim diplome apo provim formimi</p>

dhe peshës specifike.	për të fituar diplomën Bachelor në Financë me dy profilet Financë e Bankë. Gjithashtu, një kriter është edhe rezultati i studentit, notat e marra prej tij gjate tre viteve.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Personeli akademik i programit të studimit, ndihmon dhe orienton studentët për mënyrën e zhvillimit të provimit për mbrojtje diplome. Sipas rregullores së Sekretarisë neni 42, udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur dhe afate të përafërta për realizimin e punës së tij. Studentët duhet të respektojnë afatet e vendosura për të mundësuar mbrojtjen e temës në sezonin normal të mbrojtjes diplomës. [Evidenca 63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf; Aneks nr 58 Rregullore e programit.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 36] [Evidenca 63 FE Proçedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf; Evidenca 95 Rregullorja e Sekretarise.pdf]
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Sipas RVB-së, institucioni mund të asistojë studentët për kryerjen e testeve, mbledhjen e të dhënave, analizimin e tyre, duke përdorur mjediset e Fakultetit Ekonomik, UMT, në varësi të fushës së kërkimit. Të gjitha burimet didaktike, informatike, salla, biblioteka dhe specialistët e IT vihen në dispozicion të studentëve nëse do u nevojitet mbështetje për këtë çështje.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	[Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 36]
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas RVB, dhe Rregullores së Sekretarisë neni 45, fq 14, rezultoni se në përfundim të mbrojtjes së provimit apo të diplomës, studenti vlerësohet me pikë nga komisioni përkatës i ngritur me vendim të Dekanit. Këto pikë konvertohen më tej në notë përfundimtare të vlerësimit, dhe përfiton kredite, qoftë të provimit apo të temës së diplomës. [Evidenca 95 Rregullore e sekretarisë fq 14; Evidenca 120 UMT Rregullore e provimeve.pdf; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 36]
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sipas nenit 91, të ligjit 80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor ne RSH", referuar dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni në ëeb si: Rregullore e Sekretarisë, dhe dokumenta të tjera të referuara më poshtë, në përfundim të studimeve cdo student pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, ashtu sikurse janë të miratuara nga MASR. [Aneks nr 59 Modeli i diplmes per programin.pdf; Aneks nr 60 Suplementi i diplomes.pdf]
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Nga vizita në sekretarinë e institucionit dhe nga dokumentat, sipas RVB, rezultoni se përveç diplomës dhe suplementit, me kërkesë të studentit, atij mund t'i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar në UMT. [Aneks nr 59 Modeli i diplmes per programin.pdf; Aneks nr 60 Suplementi i diplomes.pdf; Evidenca 95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf, neni 46; Raporti i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 37]

<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion, veçanërisht në Sekretarinë Mësimore, dhe dokumenta të tjera të institucionit në ëeb, konstatojm se institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studenteve kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Sekretaria mësimore sipas legjislacionit në fuqi, sipas Rregullores së Sekretarisë së këtij institucioni, konfirmon rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. [Evidenca 95 FE Rregullore e Sekretarisë.pdf; Evidenca 114 UMT Rregullore e arkivës.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf, fq 37fj]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, anekseve bashkëngjitur dhe atij të marrë gjatë vizitës në Universitetin Metropolitan të Tiranës (UMT), GVJ-ja konkludon se struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë” është zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Gjatë vizitës pranë kësaj zyre GVJ konstatoi se kjo zyrë mban të dhëna në formën e dosjeve personale (format letër) për të gjithë personelin me kohë të plotë ose me kontratë dhe bën përditësimin e tyre. [Referenca: 10_ Organigrama UMT.pdf; 99_Udhëzim mbi procedurën e rekrutimit të personelit akademik.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni faqen Ëeb të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UMT-se.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare Ëeb të universitetit dhe janë në përputhje me specifikat e programit të studimit. [Referenca: Evidenca</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 44

specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf; 99_Udhëzim mbi procedurën e rekrutimit të personelit akademik.pdf]			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, si dhe nga dokumentacioni shtesë i dërguar nga institucioni, GVJ-ja konstatoi ndjekjen e procedurave të rekrutimit në përputhje me kriteret ligjore, statutin e UMT-se, si dhe udhëzimin mbi procedurën e rekrutimit të personelit akademik.</p> <p>Procedura e rekrutimit të stafit që ndiqet nga UMT konsiston fillimisht në publikimin e vendeve vakante në faqen e Eëb të institucionit, me kriteret e përgjithshme dhe specifike. Më pas thirren në intervistë kandidatët e përzgjedhur, të cilët intervistohen nga një komision ad-hoc i krijuar nga Bordi i Administrimit të UMT-se.</p> <p>Përmbajtja e dosjes së personelit akademik është: Kontratë individuale; tabelë mbi veprimtarinë; ngarkesa mësimore; vërtetim; raport mjekësor; diplomat (bachelor, master, etj., si dhe listat e notave shoqëruese); certifikatë personale; aplikim për dëshminë e penalitetit (në një të dosje mungonte dëshmia e penalitetit); CV; librezë pune; certifikatë mbrojtje e gjuhës së huaj. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf; 99_Udhëzim mbi procedurën e rekrutimit të personelit akademik.pdf; Dokumenta shtesë- dokument rekrutimi.pdf;]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	0	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Referuar takimeve dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në UMT, GVJ-ja konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”</p> <p>Godinat në të cilat zhvillohen aktivitetet mësimore të këtij programi studimi janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe efikent të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf; 20_ Evidenca 14-Rregullore e Etikës.pdf; 69_Evidenca 107 FE_Ambjentet për Infrastrukturën.pdf; 70_Evidenca 108 FE_Asete infrastrukurore, akademike.pdf]</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Programi i studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë” administrohet nga Departamenti Financë - Bankë, i Fakultetit të Ekonomisë të UMT. Në takimin me personelin akademik të programit të studimit, GVJ-ja konstatoi angazhimin dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 45

	<p>mbështetjen e UMT-se për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik nëpërmjet përfshirjes në marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me institucione partnere ndërkombëtare dhe kombëtare në nivel kërkimi, mësimdhënieje dhe projektesh të ngjashme.</p> <p>Gjithashtu, gjatë këtij takimi personeli akademik dëshmoi edhe për mbështetjen financiare të marrë për pjesëmarrje dhe referime në konferenca shkencore. [Referenca: 9_Evidenca 3_Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf; 46_Evidenca 50_Rregullore e FE.pdf; 47_Evidenca 73_FE_Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar.pdf;]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar si dhe në vizitën në Institucion, GVJ-ja konstaton angazhimin e UMT-se në nxitjen dhe mbështetjen e personelit akademik për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie, si dhe përdorimit të teknologjive të reja. Ky angazhim konsiston kryesisht në dy drejtime: së pari, nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte kërkimore e shkencore, kryesisht me universitete dhe institucione të huaja. Mobilitetet e stafit të këtij programi për trajnime dhe mësimdhënie në institucione të huaja, sjellin eksperiencat më të mira të huaja dhe përshtatjen e tyre për studentët e UMT-se; së dyti, nëpërmjet trajnimeve për përdorimin e platformave të ndryshme online (kryesisht edu4school). Përmendim që gjatë situatës së pandemisë Covid-19, UMT rifilloi mësimin online për studentët brenda 4 ditësh nga ndërprerja e mësimin në auditor.</p> <p>[Referenca: 44_Evidenca 48 UMT_Platforma për mësimin online.pdf; 97_Evidenca 27 UMT_Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit, mobilitetit.pdf;]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar =dokumentacionin e dorëzuar nga UMT si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se aktualisht personeli akademik efektiv (PAE)mbulon mesatarisht 4 lëndë (2 për çdo semestër, në të gjitha programet dhe nivelet e studimit) me një ngarkesë totale orare që varion nga 200-300 orë. Personeli akademik efektiv mbulon 73,8% të programit mësimor, ndërsa 26,2% e këtij programi mbulohet nga personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>GVJ-ja gjykon se referuar numrit të lëndëve, si dhe numrit relativisht të ulët të studentëve në këtë program studimi, kjo ngarkesë mësimore nuk çënon realizimin cilësor të objektivave të programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar. [Referenca: 143_Tabela 4_Ngarkesa totale e personelit akademik.pdf; 145_Tabela 9_Plani Mësimor për Programin bachelor.pdf; 135_Aneks 69_Të dhëna për mbulimin e lëndëve me personel akademik.pdf]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 46

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UMT siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”, duke ofruar 2 godina përkatësisht me sipërfaqe 2.347m² dhe 2.490m². Këto godina janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. UMT ofron 6 laboratorë informatike dhe një sallë biblioteke.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mësimi në këtë program studimi kryesisht zhvillohet pasdite. Gjithashtu në takime u deklarua se për shkak të numrit të vogël të studentëve në këtë program studimi bashkoheshin leksionet e përbashkëta me programet e tjera të nivelit bachelor të ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës së ambjentëve ku zhvillojnë mësim studentët e këtij program studimi, u konstatua se sipërfaqja e klasave është e përshtatshme për numrin aktual të studentëve. Klasat janë të pajisur me kompjuter, videoprojektor dhe mjete të tjera të domosdoshme për të realizuar procesin mësimor dhe një mësimdhënie sa më cilësore. Studentët konfirmuan që leksionet dhe prezantimet e tjera zhvilloheshin duke përdorur mjete audiovizive të cilat disponoheshin nga pedagogu i departamentit përkatës përgjegjës për mbulimin e lëndës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Në dispozicion të këtij program studimi janë 2 laboratore informatike të pajisur me nga një kompjuter për çdo student.</p>
	<p>Siç u përmend edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi (IV-3) në dispozicion të këtij programi studimi janë 2 laboratore informatike të pajisur me nga një kompjuter për çdo student. Në laboratorin ku zhvillohet lënda e informatikës janë të instaluar programe të ndryshme në funksion të përmbushjes së programit të lëndës, ndërkohë në laboratorin që përdoret për lëndët profesionale është i instaluar programi kontabël Alpha.</p> <p>Studentët mund të përdorin mjediset laboratorike edhe për të realizuar detyrat e kursit (individuale apo në grup), si edhe për punime të tjera të ngjashme.</p> <p><i>[Referenca: 69 Evidenca 107 FE_ Ambjentet për infrastrukturën te UMT-FE.pdf; 70 Evidenca 108 FE_ Asete infrastrukurore, akademike_UMT.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të</p>	<p>Në kurrikulën e këtij program studimi është parashikuar një praktikë mësimore, në një total prej 150 orë praktikë profesionale/mësimore. Studentët duhet të realizojnë 120 orë pranë institucioneve ku zhvillojnë praktikën, ndërsa 30 orë janë punë e pavarur e studentit që</p>

posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	zhvillohet në auditorët e UMT-së. Institucioni ka nënshkruar një sërë marrveshesh me Institucione të tjera privatë apo publik për realizimin e një praktike sa më profesionale, në mënyrë që studentët të vënë në praktikë njohuritë e fituara në auditorët e UMT-së. [Referenca: 69_Evidenca 107 FE_Ambjentet për infrastrukturën te UMT-FE.pdf; 70_Evidenca 108 FE_Asete infrastrukturore, akademike UMT.pdf; 145_Tabela 9_Plani Mësimor për Programin bachelor.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga UMT-ja si dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se UMT-ja vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij universiteti bibliotekën, e cila ndodhet në katin e parë të godinës 1. Studentëve u ofrohet mundësia e shfrytëzimit të bibliotekës si paradite, ashtu edhe mbasdite.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, revista dhe botime të institucioneve të tjera; e cila mund të shfrytëzohet njëlloj nga të gjithë studentët dhe stafi i universitetit, megjithatë kjo literaturë është e kufizuar dhe e vogël në numër. Nga stafi drejtues na u tha që në objektivat e këtij institucioni është shtimi i fondit të literaturës të bibliotekës. Mendojmë që në literaturën e bibliotekës (fizike dhe online) nevojitet një investim i konsiderueshëm. [Referenca: 71_Evidenca 109 FE_Relacion biblioteka dhe laboratore informatike UMT FE.pdf; 72_Evidenca 110 FE_Lista e botimeve.pdf]
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga UMT-ja dhe vizitën në institucion, GVJ-ja konstaton se UMT-ja nuk ofron shumë mundësi për studentët e këtij program studimi për akses on-line në biblioteka apo botime të tjera që lidhen me këtë program studimi. Edhe gjatë takimit me studentët ata konfirmuan që përdornin bibliotekën vetëm për të konsultuar literaturën fizike.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Edhe në RVB (kriteri 4, standarti IV.2) specifikohet që ofrohet aplikacioni “edu4school” ku studentët kanë akses në materialet dhe literaturat që ofrojnë pedagogët e lëndëve. Ndërkohë biblioteka është e pajisur me kompjutera, të cilët shfrytëzohen nga studentët kryesisht për punët e detyrave të kursit në grup ose individuale. [Referenca: 71_Evidenca 109 FE_Relacion

	<i>biblioteke dhe laboratore informatike UMT FE.pdf; 72_Evidenca 110 FE_Lista e botimeve.pdf]</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Mbështetur në informacionin e RVB-së, në kriterin përkatës, institucioni parashikon çdo vit fonde për shtimin e zërave të bibliotekës, megjithatë GVJ-ja sugjeron që të shikohet me prioritet investimi në bibliotekën e UMT-së në mbështetje të programit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”, si në aspektin e literaturës fizike, ashtu edhe në përdorimin e bibliotekës on-line (evidentuar edhe nga vetë institucioni në pikat e dobta në fund të RVB-së). [Referenca: 71_Evidenca 109_FE_Relacion biblioteke dhe laboratore informatike UMT FE.pdf; 72_Evidenca 110_FE_Lista e botimeve.pdf]			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi që biblioteka e UMT-së vihet në dispozicion të studentëve që ndjekin këtë program studimi për përdorim nga ora 10:00-21:00, duke u ofruar mundësinë e përdorimit të literaturës të gjithë studentëve të këtij program studimi. Sipërfaqja e bibliotekës nuk është shumë e madhe, por është e mjaftueshme për numrin aktual të studentëve që ofron ky program studimi (përkatësisht për çdo vit akademik 18+12+17=47 studentë në total). Institucioni duhet të rrisë sipërfaqen kushtuar bibliotekës pasi biblioteka është në funksion të të gjithë studentëve të UMT-së (niveli Bachelor dhe Master) dhe jo vetëm të studentëve të këtij programi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon një sistem të kompjuterizuar “edu4school” që është në funksionim nga fillimi i vitit akademik 2019-2020. Ky sistem administron informacionin për studentët që nga regjistrimi i tyre deri në mbylljen e programit të studimit. Informacioni për studentët konsiston kryesisht në të dhëna personale dhe vlerësime me nota. Ndërkohë sekretaria mësimore është struktura që administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi. Gjatë vizitës në sekretari GVJ-ja verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë” dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; Evidenca 8_Rregullore e UMT-së.pdf; 112_Evidenca 95_Rregullore e sekretarisë.pdf]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, specifikisht nenit 9,10,11,12 të Rregullores së UMT-së dhe informacionit të marrë në

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 49

<p>aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë” realizohet nga zyra e Burimeve Njerëzore në formën e dosjes personale të personelit. [Referenca: Evidenca 8_Rregullore e UMT-së.pdf]</p>			
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga Institucioni dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UMT, GVJ-ja konstatoi se platforma “edu4school” është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë.</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Aktualisht shkëmbimet e informacionit ndërmjet përdoruesve të platformës përqendrohen kryesisht në përdorimin e platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si programi mësimor, syllabuset e çdo lënde, materialet e ofruara nga pedagogët e lëndës, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar, listat e notave dhe krediteve.</p> <p>Në vitet e kaluara akademikë UMT ka përdorur sistemin e informacionit të sekretarisë on-line (SIS) dhe portali i studentëve. Komunikimi (personel akademik, studentë, personel joakademik) realizohet edhe nëpërmjet adresave elektronike të emailit me domain umt.edu.al.</p> <p>Komunikimi ndërmjet rrjeteve sociale është një formë tjetër interaktive në funksion të lehtësimit të këtij program studimi.</p> <p>[Referenca: Evidenca 43 UMT Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf; Evidenca 43 UMT Manual përdorimi të sistemit informatik të studentëve.pdf; Evidenca 7 Statuti i UMT-së.pdf; Evidenca 8 Rregullore e UMT-së.pdf; 112 Evidenca 95 Rregullore e sekretarisë.pdf]</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platforma “edu4school” garanton monitorimin e aktivitetit akademik pasi të gjitha transaksionet lënë gjurmë. Të gjitha analizat statistikore ofrojnë informacion për të vlerësuar ecurinë e procesit mësimor në këtë program.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen e internetit të UMT ofrohet një larmishmëri informacionesh në lidhje me programet e studimit, personelin akademik, si dhe një vend të rëndësishëm zë publikimi i ilustruar edhe me fotografi i aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen pranë tij.</p> <p>Informacioni në faqen e Eëb ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.6
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe

mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. UMT harton planin financiar ku llogarit koston për student, por jo specifikisht për këtë program studimi. Gjithashtu në <i>aneksin nr. 118-shpenzimet dhe të ardhurat</i>, paraqiten disa burime të ardhurash për institucionin që të mbështesin edhe mbarëvajtjen e këtij program studimi. [Referenca: 80_Evidenca 118_FE_Shpenzime dhe të ardhura në 3 vitet e fundit.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit, buxheti dhe analiza financiare realizohet mbi bazë institucioni dhe jo mbi bazën e programeve të studimit. Ky plan financimi është i detajuar me zërat përkatës të mbulimit të pagesës së orëve të mësimit për personelin akademik efektiv dhe personelin akademik me kontratë, personelin jo akademik, mirëmbajtjen e ambjentëve dhe klasave, shpenzimet për bibliotekën, grantet vendëse dhe të huaja (kryesisht nëpërmjet projekteve). Në analizën financiare të institucionit janë të detajuar pjesa e shpenzimeve dhe të ardhurave, në zëra bruto për Fakultetin e Ekonomisë, që ka pjesë të tij edhe Departamentin e Financë-Kontabilitetit që është përgjegjës edhe për këtë program studimi. [Referenca: 80_Evidenca 118_FE_Shpenzime dhe të ardhura në 3 vitet e fundit.pdf; 89_Evidenca 128_FE_Buxheti i UMT_FE.pdf; Dokumenta shtesë 6_Mbi qëndrueshmërinë financiare.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifata e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Referuar dokumentacionit edorëzuar, Institucioni kryen auditim ligjor të përvitshëm nga audituesi ligjor B.Husi. Ky auditues çdo vit harton një raport në lidhje me transparencën financiare të institucionit, duke analizuar edhe të ardhurat dhe kostot për studentët. Ky auditues ligjor i pavarur ofron opinion lidhur me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standartet kontabël. [Referenca:90_Evidenca 129_FE_Evidencë auditimi financiar.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni nuk dokumenton raporte financiare për programin në vecanti siç u përmend edhe në kriterin 2 të këtij standarti. Ndërkohë raporte financiare ofrohen në rang institucioni dhe feedback-u i marrë reflektohet në projekt buxhetin e vitit pasardhës në funksion të mbarëvajtjes normale të programeve të studimit pranë këtij institucioni.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Pasqyrat financiare të Institucionit dhe raportet e auditit ligjor të pavarur për performancë financiare të institucionit, dëshmojnë se institucioni ka kapacitete për të përmirësuar situatën financiare në të ardhmen. Gjatë horizontit të fundit 3-vjecar UMT-ja ka arritur të ketë një rritje të ardhurash nga tarifata e studimit me një mesatare prej 11%, duke cuar në një rritje të normës së fitimit mbi xhiron vjetore nga 5% në 7%. Këto shifra justifikojnë qëndrueshmërinë financiare të</p>

	institucionit. [Referenca: 80_Evidenca i 118 FE_Shpensime dhe të ardhura në 3 vitet e fundit.pdf; 89_Evidenca 128 FE_Buxheti i UMT_FE.pdf; Dokumenta shitesë_6_Mbi qëndrueshmërinë financiare.pdf; 90_Evidenca 129_FE_Evidencë auditimi financiar.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1				
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, si dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion dhe nga faja Eëb zyrtare e UMT, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe statutin e rregulloren e UMT. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf]			
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentët dhe studentët e programit të studimit.	Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej edhe nga kërkesat specifike të statutit të UMT (Kreu V, nenet 67-72) dhe të rregulloreve respektive të Fakultetit Ekonomik (neni 20-33) dhe të programit të studimit (neni 13-26).			
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në takimin me studentët e këtij programi studimi dhe nga faja Eëb e UMT-se, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf; 46_Evidenca 50_Rregullore FE.pdf; 130_Aneksi 58_Rregullore e programit.pdf]			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Përpara fillimit të vitit akademik institucioni publikon on line (në faqen Eëb), si dhe në formën e materialit të aksesueshëm gjatë vizitave në institucion dhe gjatë fushatës sensibilizuese nga UMT-ja, kriteret e përgjithshme dhe specifike për programin e studimit Bachelor në "Financë" me profile "Kontabilitet" dhe "Bankë"			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Këto kriteret hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë së arsimit, si dhe me kuotat e miratuara të pranimit për këtë program studimi. Parashikohen gjithashtu kuota për studentët e huaj dhe kategori të caktuara në përputhje me VKM-ne përkatëse.			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Fushata sensibilizuese për tërheqjen e kandidatëve për studentë në këtë program studimi organizohet kryesisht nga Fakulteti i Ekonomisë dhe sektori i marketingut pranë UMT-se. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 100_Evidenca 30_Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimi në programet e UMT.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 53

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga UMT dhe vizitën në institucion konkludon se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh. Këto kritere dhe procedura janë pjesë e Rregullores së UMT-së, si dhe Rregullores së programit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë”</p> <p><i>[Referenca: 46_Evidenca 50_Rregullore FE.pdf; 130_Aneksi 58_Rregullore e programit.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparëshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh. Procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh përfshijnë vlerësimin e dosjes së studentit aplikant për transferim nga ana e një komisioni për vlerësimin dhe transferimin e krediteve që shqyrton dhe vlerëson dosjen për efekt ekuivalentimi të krediteve në përputhje me udhëzimet ligjore në fuqi dhe rregulloret përkatëse të institucionit (përmendur më në kriterin e mësipërm).</p> <p>Studentët e programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë” informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në momentin e regjistrimit pranë UMT. <i>[Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf; 46_Evidenca 50_Rregullore FE.pdf; 130_Aneksi 58_Rregullore e programit.pdf; 100_Evidenca 30_Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf; 63_Evidenca 90_Shembull dosje transferim studimesh.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së UMT-së, Rregullores së provimeve, Rregullores së programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara në platformën “edu4school”, si dhe prezantimit të pedagogut të lëndës në orën e parë të mësimin.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ-ja konstatoi se studentët ishin të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi. Në përputhje me Rregulloren e UMT-së dhe Rregulloren e programit të studimit “Bachelor në Financë me profile” procedura e mbrotjes së diplomës për studimet bachelor është me provim diplome. Ky provim diplome bazohet në një bankë pyetjesh që përfshin testimin e njohurive të marra gjatë tre viteve të programit të studimit. Banka e pyetjeve përgatitet nga personeli akademik i Departamentit përgjegjës për programin e studimi.</p> <p>GVJ gjykon se studentëve me mesatare të lartë duhet t’ju ofrohet</p>

	<p>përmbyllja e studimeve me një punim diplome apo punim teze diplome, bazuar në njohuritë e marra gjatë shkollimit. Përmbyllja e një cikli studimi me një punim individual do rriste edhe vetvlerësimin e studentëve, si dhe do të nxiste ata për punime sa më cilësore. Studentët të këtij programi studimi, kanë marrë pjesë në konferenca shkencore studentore dhe më gjerë, gjë që justifikon potencialin e tyre për realizimin e një punimi përmbyllës diplome.</p> <p>GVJ gjatë takimit me studentë, konstatoi se sa më lart ishte e preferueshme edhe nga studentët pavarësisht se ata nuk e kishin kërkuar këtë gjë tek pedagogët apo instancat drejtuese të Departamentit të Financë-Bankës. [Referenca: 8_Rregullore UMT.pdf; 130_Aneksi 58_Rregullore e programit.pdf; 82_Evidenca 120_Rregullore e provimeve.pdf; 128_Aneks nr 56.1 Plan programet e lendeve programi Finance-Syllabus.pdf]</p>								
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur nga UMT-ja, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare Eëb, GVJ-ja konstaton se Departamenti i Financë-Bankës dhe zyra e marketingut dhe e shërbimit ndaj studentëve përpara fillimit të çdo viti akademik realizojnë aktivitete informuese në qytete të ndryshme të Shqipërisë, takime me institucione publike dhe private, merr pjesë në panairë pune, rrjete sociale dhe shpërndan fletëpalosje për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi të gjitha programet e studimit. [Referenca: 121_Evidenca 104_Aktivitetet e kryera nga studentët, qeveria studentore UMT.pdf]</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Plotë përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Plotë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Plotë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë” në fillim të çdo viti akademik informohen nga pedagogët e Departamentit Financë-Bankë për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Sekretaria mësimore gjithashtu mbështet studentët me informacion në lidhje me procesin mësimor, për çdo pyetje apo paqartësi që mund të kenë studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjithashtu në dispozicion të studentëve janë edhe materialet informuese si fletëpalosje dhe broshura të përgatitura mbi modulet, lëndët, etj të programit të studimit të përgatitura nga UMT. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf; 46_Evidenca 50_Rregullore FE.pdf; 130_Aneksi 58_Rregullore e programit.pdf]</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues të Zyrës së të Këshillimit dhe Karrierës, dhe Shërbimit ndaj Studentëve gjatë vizitës në institucion, rezultoi se kjo strukturë kujdesej kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit.</p> <p>GVja konstatoi që roli i rrjetit ALUMNI në këtë institucion duhet të jetë më i madh. Studentët e vitit të tretë të këtij program studimi janë brezi i parë i të diplomuarve, por ndërkohë Fakulteti i Ekonomisë ka diplomuar studentë prej vitesh. Kjo nënkupton që rrjeti ALUMNI që i referohet studentëve të diplomuar më parë pranë këtij fakulteti, duhet të ketë një rol më të madh në informimin e studentëve drejt nevojave të tregut të punës, dijeve që nevojiten, praktikave mësimore si dhe mundësive për punësim. [Referenca: 50_Evidenca 77 FE Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.pdf]</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ-ja konstaton se pedagogët e departamentit Financë-Bankë, dhe në mënyrë më të dedikuar Këshilltari Akademik i studentëve, luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Nëpërmjet faqes Eëb zyrtare të UMT-se dhe hapësirës së dedikuar në platformën "edu4school, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, mund të regjistrohen në leksione dhe seminare sipas programit të studimit, të konsultojnë vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar sipas lëndëve që kanë frekuentuar, orarin e provimeve, etj, si dhe të informohen lidhur me infrastrukturën dhe aktivitete të tjera të organizuara në nivel universiteti. [Referenca: 8_Rregullore UMT.pdf; 39_Evidenca 43_Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve.pdf; 74_Evidenca 112 UMT Vendim për përcaktimin e Këshilltarve Akademik sipas viteve të studimit.pdf; 85_Evidenca 123 FE Axhenda e Këshilltarve Akademik sem.II online.pdf]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e</p>	<p>Ky është brezi i parë i studentëve që do të diplomohen në këtë program studimi, kështu që nuk ka statistika për numrin e të diplomuarve në këtë program.</p>

<p>studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve, si dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari janë të formatuar sipas standardeve shtetërore. Pranë sekretarisë depozitohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.</p>																
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretari, GVJ-ja verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në “Financë” me profile “Kontabilitet” dhe “Bankë” dhe konstatoi shkallen e plotesimit të tyre. Dosja e studentit përmban: të dhënat, kontratë, deklaratë, fotografi, ID, diplomë e noterizuar bashkë me listën e notave, dokumentacion mbi performancën, procesverbal detyrimesh dhe lista e notave.</p> <p>Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë:</p> <table border="1" data-bbox="660 712 1305 927"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve</th> <th>Të transferuar</th> <th>Të e' rregjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>18 studentë</td> <td>1 std.</td> <td>7 std.</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>12 studentë</td> <td>4 std.</td> <td>2 std.</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>17 studentë</td> <td>6 std.</td> <td>2 std.</td> </tr> </tbody> </table> <p>Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. [Referenca: 60_Evidenca 87 FE_Shembull dosje studenti të regjistruar.pdf; 112_Evidenca 95 FE_Rregullore e Sekretarisë.pdf]</p>	Viti akademik	Nr. i studentëve	Të transferuar	Të e' rregjistruar	2017-2018	18 studentë	1 std.	7 std.	2018-2019	12 studentë	4 std.	2 std.	2019-2020	17 studentë	6 std.	2 std.
Viti akademik	Nr. i studentëve	Të transferuar	Të e' rregjistruar														
2017-2018	18 studentë	1 std.	7 std.														
2018-2019	12 studentë	4 std.	2 std.														
2019-2020	17 studentë	6 std.	2 std.														
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ-ja konstaton se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kërkesat e statutit dhe rregullores së UMT-se. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër dhe në sistemin e menaxhimit informatik ruhet në versionin elektronik. Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. [Referenca: Evidenca 7 Statuti i UMT-së.pdf; 8 Rregullore UMT.pdf]</p>																
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentave të dorëzuar nga institucioni, dokumentave shtesë që u kërkuan gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se institucioni nëpërmjet njësive bazë analizon profilin dhe cilësinë në hyrje të studentëve (nota mesatare), si dhe bën një statistikë të cilësisë (nota mesatare) dhe të kalueshmërisë (në %) sipas lëndëve dhe programeve të studimit (analizat vjetore të departamentit). Nuk ka raporte apo statistika mbi cilësinë në dalje të studentëve dhe punësimin e tyre, pasi ky është brezi i parë i të diplomuarve në këtë program studimi.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion kërkoi statistikat e cilësisë së studentëve deri në momentin aktual gjatë vizitës në institucion dhe të dhënat janë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="715 1861 1249 1906"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Mesatarja në</th> <th>Mesatarja deri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Mesatarja në	Mesatarja deri													
Viti akademik	Mesatarja në	Mesatarja deri															

			hyrje	tani
			2017-2018	7,28
			2018-2019	7,8
			2019-2020	8,5
	[Referenca: Dokumenta shtesë 1 Cilësia në dalje e studentëve.pdf; 2.12 Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit të Finances dhe Kontabilitetit.PDF;]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga UMT dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se UMT-ja ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatën Akademik të UMT, në Komisionin për garantimin e standarteve dhe cilësisë së procesit mësimdhënës dhe mësimnxënës, si dhe ngritjen e Këshillave Studentore në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e UMT-se. [Referenca: Evidenca 7 Statuti i UMT-së.pdf; 18 Evidenca 12 Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT.pdf; 8 Rregullore UMT.pdf; 15 Evidenca 9 UMT Rregullore e NJSBC.pdf; 14 Evidenca 8 UMT Përbërja e NJSBC.pdf]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se aktualisht UMT-ja përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe stafit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga zyra e NJSBC-së dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve, i cili u komunikohet organeve drejtuese dhe më pas të gjitha njësisive bazë për një analizë aktive të rezultateve. Gjithashtu departamenti i Financë-Bankës, përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe këshilltarit akademik, siç doli edhe në takimin që GVJ-ja realizoi me studentët në institucion. [Referenca: 16 Evidenca 10 Analiza e NJSBC për pyetësorët e personelit akademik.pdf; 17 Evidenca 11 Model i pyetësorit për studentët.pdf]
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në	Duke ju referuar informacionit të paraqitur nga institucioni dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në UMT, rezulton se në hartimin dhe ndryshimet e bëra në vite në programin e studimit Bachelor në “Financë” me profile

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 58

<p>programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>“Kontabilitet” dhe “Bankë” është mbajtur parasysht ngarkesa akademike e studentëve. Numri total i orëve në auditor dhe jashtë auditorit për çdo vit akademik është 1.500 orë mësimore. Gjithashtu shpërndarja e krediteve dhe syllabuset e lëndëve janë të strukturuar në mënyrë të tillë që lehtësojnë procesin e transferimit të studentëve si nga jashtë UMT, ashtu dhe ndërmjet degëve brenda Fakultetit të Ekonomisë të UMT. [Referenca: 100_Evidenca 30_Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf; 124_Aneks 54 Plani Mesimor per programin Bachelor ne Finance Profili Kontabilitet viti 2019-2020.pdf]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>UMT-ja merr ne konsiderate opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet këshilltarit akademik dhe koordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyestorëve (ku janë përfshirë edhe pyetje të hapura për të marrë feedback sa më të mirë dhe më të gjerë). Këto raporte u dërgohen edhe Përgjegjësve të Departamentëve të cilët i kalojnë për diskutim në mbedhje departamenti dhe merren vendimet përkatëse duke reflektuar në hartim, rishikim dhe përmirësim programi. [Referenca: 16_Evidenca 10 Analiza e Njsbc për pyetësorët e personelit akademik.pdf; 17_Evidenca 11 Model i pyetësorit për studentët.pdf; 14_Evidenca 8 _UMT Përbërja e Njsbc.pdf]</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e UMT-se dhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Financë me profile, parashikon të drejtën e ankimimit, për të gjithë studentët lidhur me procesin dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, brenda 3 ditëve nga marrja e rezultatit të provimit, duke depozituar një kërkesë me shkrim pranë Departamentit të Financë-Bankës. Nëse edhe pas ballafaqimit me pedagogët e lëndës dhe tezën e provimit, studenti vazhdon të ketë pretendime për vlerësimin, atëherë ngrihet një komision shqyrtues nga Përgjegjësi i Departamentit që merr edhe vendimin përfundimtar për vlerësimin e tezës.</p> <p>Studentët jane ne dijeni përpara se të hyjnë në provim per pikët e fituara nga vlerësimi i vazhduar, ndërkohë që pikët dhe nota e provimit ju komunikohet brenda 3 ditëve nga data e provimit. I gjithë ky informacion ju ofrohet edhe nëpërmjet platformës Edu4school.</p> <p>Studentët mund të shprehin mendimin e tyre në pyetësorët përkatës lidhur me cilësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. [Referenca: 82_Evidenca 120_Rregullore e provimeve.pdf]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në Statutin dhe rregulloren e UMT-se dhe të programit të studimit përcaktohen procedurat dhe njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si sekretaria mësimore e programit të studimit; këshilltari akademik; koordinatori për marrëdhëniet me studentët; si dhe zyra e informimit dhe këshillimit të karrierës dhe zyra e shërbimit ndaj studentit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Financë-Bankës, që është edhe njësi bazë që mbulon këtë program studimi është përgjegjës për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve nëpërmjet njësi të sipërpërmendura, por edhe stafit të saj akademik. Koordinatori i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Ndërkohë këshilltari akademik në komunikimin e vazhdueshëm me studentët nxjerr në pah problematikat e ndryshme që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe bën raportimin e tyre në Departamentin e Financë-Bankës.</p> <p>Specialistët e zyrës së marketingut, ALUMNI dhe Këshillimit të Karrierës synojnë që nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme të nxisin jetën kulturore, artistike, sportive të studentëve gjatë viteve të studimit dhe të përgatisin sa më mire, vecanërisht studentët e vitit të fundit për tregun e punës. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf; 46 Evidenca 50_Rregullore FE.pdf; 130_Aneksi 58_Rregullore e programit.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ-ja konstaton se shërbimi i këshillimit për studentët në UMT-ja ofrohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Marketingut dhe Alumni dhe në nivel program studimi nga Koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Koordinatori në bashkëpunim me Këshilltarin Akademik të studentëve evidentojnë problematikat e ndryshme që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe bëjnë raportimin e tyre në Departamentin e Financë-Bankës.</p> <p>Specialistët e zyrës së Këshillimit të Karrierës, e marketingut dhe Alumni këshillojnë studentët për të gjitha hallkat e procesit mësimor duke synuar përgatitjen e tyre për tregun e punës. Nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme si summer school, ëinter school, leksione të hapura, Workshop-e, etj, synohet të rritet pjesëmarrja aktive dhe të promovohen studentët, si dhe të rriten mundësitë e punësimit të tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Financë-Bankës dhe zyra e Marketingut udhëzon dhe ndihmon studentët për të zgjedhur institucionet ku do të kryejnë praktikën profesionale, si pjesë e kurrikulës së këtij programi.</p> <p>Zyra e marketingut ka për detyrë të ndjekë studentët pas përfundimit të studimeve. Megjithatë ky program studimi këtë vit akademik prodhon të diplomuarit e parë.</p> <p>Ritheksojmë edhe këtu që roli i ALUMNI duhet të rritet me qëllim që në kurrikulën e këtij program studimi të përfshihet edhe opinioni i tyre, pasi</p>

	duke njohur shumë mirë edhe universitetin, edhe tregun e punës ata mund të japin një feedback me shume vlerë në funksion të përmirësimit të programit, si dhe të rritjes së mundësive të punësimit të studentëve. [Referenca: 50_Evidenca_77_Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT.pdf; 51_Evidenca_78 FE Aktivitetet e Zyrë së Karrierës.pdf; Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në informacionin e paraqitur dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se në UMT Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NJSBC-ja pranë UMT është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 15_Evidenca 9_Rregullore e NJSBC.pdf]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Funksionimi dhe organizimi i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazohet në statutin e UMT-se. Aktualisht fokusi kryesor i punës është analiza dhe vlerësimi i pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UMT. Në përbërje të NJSBC-së janë: 3 personel akademik, 1 përfaqësues i studentëve, 1 ekspert i jashtëm dhe 1 përfaqësues i administratës. UMT-ja i është nënshtruar procesit për akreditimin institucional dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar pozitiv më 15.12.2017 (për 5 vjet), të shoqëruar me disa rekomandime, nga Bordi i Akreditimit. Sigurimi i cilësisë brenda UMT-se sigurohet nga zyra e NJSBC-së dhe Fakulteti i Ekonomisë. GVJ nuk konstatoi përdorime të vlerësimeve analitike krahasuese apo të instrumenteve të tjera në funksion të plotësimit të këtij kriteri. [Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 15_Evidenca 9_Rregullore e NJSBC.pdf; Vendimi i BA të ASCAL datë 15.12.2017.pdf]
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen raportim gjashtëmujor (mbi bazë semestrash), kryesisht në formën e një raporti analize mbi

<p>periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo program studimi në UMT. Pyetësorët plotësohen përpara përfundimit të çdo semestri. Pyetësorët plotësohen vetëm fizikisht. Gjykojmë që pyetësorët duhet të plotësohen kryesisht online pasi do të ndikonte pozitivisht në transparencën e këtij procesi.</p> <p>Raportet e NJSBC-së analizohen në mbledhjen e Departamentit të Financë-Bankës dhe merren vendimet për ndryshimet në kurrikulën e programit, në syllabus të lëndëve, apo të tjera.</p> <p><i>[Referenca: Dokumenta shtesë_Ndryshim syllabusi]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>UMT-ja harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ai realizohet përmes organeve drejtuese të UMT-se, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij. Ndërkohë njësia e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit është NJSBC-ja, e cila harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Rolin thelbësor në rishikimin e kurrikulës dhe syllabuseve të këtij program studimi e ka Departamenti i Financë-Bankës.</p> <p><i>[Referenca: 13_Evidenca 7_VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf; 15_Evidenca 9_Rregullore e NjsBC.pdf]</i></p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Në takimet me personelin akademik të programit të studimit dhe drejtuesin e departamentit që administrojnë këtë program studimi, GVJ-ja konstaton se UMT-ja përdor procedura periodike dhe formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale.</p>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	<p>Çdo fillim viti akademik në departament miratohen syllabuset e lëndëve dhe reflektohen propozimet e personelit akademik të departamentit për ndryshime në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në mbledhjet e departamentit në fund të çdo semestri mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e programit të studimit.</p> <p>Në nivel universiteti, metodologjia kryesore që përdoret në UMT për verifikimin e cilësisë së zhvillimit të programit mësimor, është analiza sasiore e rezultateve të pyetësorëve të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: 4_1_Raport i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf; Dokumenta shtesë_Ndryshim syllabusi]</i></p>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe informacionit të marrë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 62

<p>vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>në takimet gjatë vizitës në UMT, rezultojnë se të gjithë të interesuarit, në të gjitha nivelet, informohen lidhur me rezultatet e vlerësimeve me pyetësorë nëpërmjet raporteve të përgatitura nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Raporti i detajuar ju shkon instancave më të larta drejtuese të UMT-se, ndërkohë në departament diskutohet një raport në vija të përgjithshme, pa emra specifik pedagogësh.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Struktura e raportit aktual sqaron bazën ligjore dhe metodologjinë e raportit, evidenton gjetjet dhe problematikat më të rëndësishme dhe jep disa rekomandime për përmirësim. Njësitë bazë vijojnë me planin e masave në përgjigje të rekomandimeve.</p>			
<p>[Referenca: 4_1_Raport i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf; 47_Evidenca 73_Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf]</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

<p>Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dërguar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se në UMT aktiviteti i NJSBC-së ka një sistem raportimi gjashtëmujor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UMT.</p> <p>Aktualisht pyetësori është uniform për të gjitha programet e studimit që ofron UMT dhe është duke u plotësuar vetëm fizikisht nëpër auditorë. Vlerësimet e NJSBC-së janë pjesë e informacionit të paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit të institucionit si dhe përdoren nga njësitë bazë dhe strukturat e tjera në analizat vjetore përkatëse. Sugjerojmë që plotësimi i pyetësorëve duhet të jetë kryesisht online për të rritur cilësinë e feedback-ut.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Financë-Bankës në hartimin e kurrikulës së këtij programi, syllabuseve të lëndëve, si dhe ndryshimeve të tyre, i referohet eksperiencave të disa prej universiteteve më të mira në vend, si dhe universiteteve të huaja me reputacion të lartë, si dhe partnerëve në projektet e përbashkëta me UMT.</p> <p>Siç theksuam edhe më sipër, Institucioni duhet të forcojë rolin e rrjetit ALUMNI, pasi feedback i tyre është shumë i rëndësishëm në përmirësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të këtij program studimi, si dhe orientimin e tij drejt tregut të punës.</p>
<p>[Referenca: 4_1_Raport i Vlerësimit të Brendshëm për programin Bsc. në Finance dhe Kontabilitet.pdf; 47_Evidenca 73_Raporti vjetor i aktivitetit</p>	

	<i>mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf]</i>		
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>Në takimet me personelin akademik të programit të studimit dhe drejtuesin e departamentit që administron këtë program studimi, GVJ-ja konstatoi se UMT-ja përdor disa procedura periodike për vlerësimin e realizimit, të mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit të studimit në nivel departamenti të tilla si: vëzhgime të programuara të zhvillimit të mësimin në auditor (më shpesh për pedagogët e rinj), analiza e rezultateve të studentëve në fund të çdo semestri si dhe rishikime vjetore të syllabuseve.</p> <p><i>[Referenca: 47_Evidenca 73_Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf;]</i></p>		
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dërguar dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UMT, GVJ-ja nuk konstatoi ndonjë përdorim sistematik të metodave apo instrumentave të tjerë të tërthortë për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>GVJ gjykon se mospërdorimi i metodave dhe instrumentave të tjerë alternativë në vlerësim, çënon cilësinë e procesit të vlerësimit.</p> <p>GVJ vlerëson se duhet të bëhen sondazhe dhe të vlerësohet opinioni dhe komentet e grupit ALUMNI. Gjithashtu të përthithet edhe opinioni, komentet dhe gjykimi i stafit akademik (PAE dhe PAK) si dhe stafit joakademik.</p> <p>Në RVB-në e hartuar nga institucioni është shprehur që planifikohen të organizohen pyetsorë edhe me aktorë të tjerë brenda institucionit.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi VL4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB në kriterin përkatës dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UMT, GVJ-ja konstaton se kuadri rregullator i UMT-se (statuti & rregullorja e UMT-se, vendimet e Senatit Akademik) parashikojnë dhe garantojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm (personeli akademik dhe joakademik, studentët) si dhe aktorë të jashtëm (institucionet bashkëpunuese, ALUMNI) në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me	UMT përveç hallkave të brendshme të institucionit të përfshira në këtë proces të rëndësishëm të përmirësimit dhe të monitorimit të cilësisë, përfshin dhe 1 ekspert të jashtëm, i cili ofron kontributin e tij përmes

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Faqe 64

përgjegjësi të këtyre detyrave.	eksperiencës në punë. <i>[Referenca: Evidenca 7_Statuti i UMT-së.pdf; 8_Rregullore UMT.pdf]</i>		
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Në takimet me personelin akademik të programit të studimit dhe drejtuesin e departamentit që administrojnë këtë program studimi, GVJ-ja konstatoi se UMT garanton përfshirjen dhe aktivizimin e tyre në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmës dhe studentëve.		
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në mënyrë periodike njësisë bazë përditësohet me informacion dhe kontribuon në procesin e vlerësimit të brendshëm me analiza, sugjerime dhe plane masash mbi raportimet e bëra nga NJSBC-ja. I gjithë stafi është i angazhuar në proces duke rishikuar syllabuset, literaturën, metodat e mësimdhënies të përdorura në funksion të përmirësimit të cilësisë. Në kodin e etikës të UMT sanksionohen parimet e etikës akademike të detyrueshme për të gjithë aktorët e brendshëm të UMT. Studentët janë gjithashtu një faktor nxitës në rritjen e cilësisë dhe opinioni i tyre konsiderohet nga institucioni. <i>[Referenca: 8_Rregullore UMT.pdf; 20 Evidenca 14_Rregullore e Etikës.pdf; 47 Evidenca 73_Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf]</i>		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi që pjesë e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë kryesisht PAK që japin mësim në këtë program studimi. GVJ vlerëson opinionin e PAK të këtij program studimi por gjykon se integrimi i formalizuar i ekspertizës nga bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm është i domosdoshëm për të rritur cilësinë e procesit të vlerësimit në mënyrë objektive. GVJ përsëri sugjeron forcimin e rrjetit ALUMNI për ndikimin në rritjen e cilësisë së programit të studimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB në kriterin përkatës dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UMT, GVJ-ja konstaton se kadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen zyrtare Ëeb të tij, të të gjitha veprimtarive (statute, rregullore) përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti. Informacioni në nivel njësisë bazë përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të
Kriteri 2. Institucioni publikon	

<p>rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>institucionit. Studentët informohen përmes njësisë bazë për problematikat e shfaqura në lidhje me cilësinë.</p> <p>Rezultatet finale të pyetësorëve bëhen publike për personelin akademik dhe studentët, por duke u ruajtur etika akademike dhe privatësia.</p> <p><i>[Referenca: 4_1_Raport i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; 47_Evidenca 73_Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Raporti i përgatitur nga NJSBC-ja mbi analizën e pyetësorëve të studentëve shoqërohet me rekomandime për përmirësimin e cilësisë, të cilat janë diskutuar më pas në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore. Në nivel njësie bazë, rezultatet analizohen me personelin akademik dhe sugjerohen masa në përputhje me gjetjet. Drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore bëjnë edhe një vlerësim të performancës së personelit akademik (me notë) bazuar në rezultatet e pyetësorëve të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: 4_1_Raport i Vleresimit te Brendshem per programin Bsc. ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; 47_Evidenca 73_Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që Institucioni e ka fokusuar kryesisht monitorimin e cilësisë nëpërmjet evidentimit të problematikave nga NJSBC-ja dhe marrjen e masave përkatëse nga Departamenti i Financë-Bankës dhe Fakulteti i Ekonomisë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me aktivitete informuese me studentë, publikime në faqen zyrtare Eëb të UMT dhe platformën edu4school, si dhe publikime në rrjetet sociale, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor ne Financë me profile “Kontabilitet” e “Bankë” të Institucionit të Arsimit të Lartë “UMT”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kujdesi ndaj studentit. Këshilltarët akademikë dhe koordinatori i programit qëndrojnë shumë pranë tyre duke evidentuar nevojat, problematikat dhe sugjerimet për programin.
2. Personeli akademik. Në këtë program studimi janë të angazhuar një numër i konsiderueshëm personel akademik me tituj e grada dhe eksperiencë të gjerë në fushën e ekonomisë.
3. Infrastrukturë koherente, e mirëpajisur dhe e pasur në laboratorë profesionalë (duke lënë mënjanë bibliotekën për të cilën rezervat janë shprehur në raportin e GVJ-së)

Pika të dobta:

1. Institucioni aktualisht u ofron studentëve vetëm provimin si mundësi për mbylljen e studimeve në ciklin e parë Bachelor, edhe pse në rregulloren e programit të studimit ofrohet mundësia e mbylljes së studimeve me provim ose diplomë. Studentët me mesatare të lartë duhet të kenë mundësi të mbrojnë një temë diplome.
2. Biblioteka jo shumë e pasur me literaturë fizike dhe online.
3. Roli i pamjaftueshëm i rrjetit ALUMNI për këtë program studimi.
4. Ndarja në dy profile e diplomës Bachelor në Financë, duke konsideruar numrin e ulët të studentëve që ndjekin këtë program studimi. Aktualisht është i hapur vetëm njëri nga profilet (i zgjedhur nga shumica e studentëve). Gjithashtu, në planin mësimor nuk është i kuptueshëm dallimi mes lëndëve të një profili dhe të profilit tjetër.

Rekomandime:

1. Të ofrohet mundësia e mbylljes së ciklit Bachelor për këtë program me punim diplome, për studentët me mesatare të lartë, sic është e përcaktuar edhe në rregulloren e Institucionit për provimet. Studentët marrin pjesë në konferenca studentore dhe më gjerë, kështu që mund të realizojnë një punim cilësor diplome.
2. Biblioteka duhet të pasurohet me literaturë fizike dhe literaturë online. Ky është edhe rekomandim i BA ne Akreditimin Institucional më datë 15.12.2017. Kështu që mendojmë që ky rekomandim duhet të konsiderohet me prioritet nga Institucioni.
3. Të rritet roli i rrjetit ALUMNI, pasi Feedback-u i tyre luan një rol të rëndësishëm në cilësinë e programit të studimit.

Edhe pse për këtë program studimi ky është brezi i parë i të diplomuarve, gjë që nënkupton që ALUMNI për këtë program nuk mund të ngrihej, Fakulteti i Ekonomisë ka diplomuar studentë prej vitesh në fushën e ekonomisë, pra rrjeti ekzistues ALUMNI (që i referohet studentëve të diplomuar më parë pranë këtij fakulteti), duhet të kishte një rol më të madh në kurrikulën e këtij programi studimi, si dhe në informimin e studentëve për nevojat e tregut të punës, praktikave mësimore si dhe mundësive për punësim.

4. Gjykojmë që diploma do ishte më e përshtatshme po të ishte pa profile duke konsideruar numrin e ulët të studentëve që ndjekin këtë program studimi. Gjithashtu kjo do të justifikonte edhe vazhdimësinë në studimet master, pasi programet e studimit Master i Shkencave edhe Master Profesional të ofruar nga ky Institucion, janë vazhdimësi e një diplome Bachelor në Financë.

Pra, duhet të justifikohet ose nëpërmjet një studimi tregu të mirëfilltë, arsyeja e ndarjes në dy profile, ose në planin mësimor duhet të ishte më i kuptueshëm dallimi mes lëndëve të një profili dhe të profilit tjetër.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in “Finance” with profiles “Accounting” and “Bank” at the “Metropolitan University of Tirana”

Strengths and affirmations:

1. The caring and support for students. The academic advisors and the program coordinator are very close to the students, identifying their needs, problems and suggestions for the program.
2. The academic staff. A considerable number of academic staff with titles and degrees and the appropriate expertise in the field of economy are engaged in this study program.
3. Coherent infrastructure, well-equipped with professional laboratories (leaving aside the library for which the reservations are already expressed in the report)

Weak points:

1. The institution actually offers to students only the exam as an opportunity for completing the Bachelor studies, although the regulation of the study program offers the possibility of completing this study cycle with an exam or diploma. High performing students should be given the opportunity to prepare a thesis (diploma).
2. The library is not too rich with physical and online literature.
3. The ALUMNI network does not have much active role in this program.
4. The division into two profiles of the Bachelor degree in Finance, considering the low number of students attending this study program. Currently only one of the profiles is created (the one chosen by the majority students). Also, in the curriculum, the difference between the subjects from one profile to another is not understandable.

Recommendations:

1. The program should offer the high performing students the opportunity of completing the Bachelor cycle with a thesis, as defined in the Institution regulation for exams. Students actually participate in student and other academic conferences, so they may come up with quality thesis.
2. The library should be enriched with physical and online literature. This is also the recommendation of AB for the Institutional Accreditation Process on 15.12.2017. So, we think that this recommendation should be considered as a priority.
3. The role of the ALUMNI network to be increased. Their feedback plays an important role in the quality of the study program.

Although for this study program this is the first generation of graduates, which means that ALUMNI for this program could not be set up, the Faculty of Economics has graduated students

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 68



for years in the field of economy. This means that the existing ALUMNI network (which refers to previously graduated students at this faculty), should have a greater role in the curriculum of this study program, as well as in informing students about the needs of the labor market, teaching practices and employment opportunities.

4. We recommend reviewing the division of the program in two profiles given the small number of students attending this study program. This would also justify the continuation in master studies as the Master of Science and Professional Master programs offered by this Institution, are the continuation of a Bachelor degree in Finance.

The reason for the division into two profiles should be justified either through thorough market study, or the difference in the curriculum of each profile should be better distinguish.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	